# RREGULLAT E PËRKOHSHME TË TREGUT SHQIPTARTË ENERGJISË ELEKTRIKE

## KAPITULLI I
## HYRJE

Këto Rregulla Tregu përcaktojnë:

i)një grup *dispozitash* që përcaktojnë procedurat për operimet dhe menaxhimin e tregut;

ii)një kuadër koherent nën të cilin pjesëmarrësit në *tregun*e energjisë elektrike mund të ndërveprojnë me njëri-tjetrin;

iii)shitjet dhe blerjet e energjisë elektrike me çmime të negociuara lirisht;

iv)kushtet për pjesëmarrje në tregun balancues të energjisë elektrike.

Këto Rregulla Tregu nxisin:

i)gjenerimin efektiv dhe furnizimin me energji elektrike;

ii)konkurrencën në shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike.

Koha – këto rregulla tregu specifikojnë se periudha e marrëveshjes financiare është 1 (një) orë në intervalin nga 00:00:01 deri në 01:00:00. Orët i referohen kohës qendrore evropiane (CET).

Monedha – gjithë pagesat dhe transaksionet financiare në tregun e balancuar do të shprehen dhe llogariten me monedhën e vendase.

Njësitë – Gjithë njësitë teknike shprehen me Sistemin Ndërkombëtar të Njësive (SI). Për shembull, gjenerimi, transmetimi dhe konsumi i energjisë elektrike (energji elektrike) shprehen me kWh (MWh, GWh), po ashtu gjenerimi, transmetimi dhe konsumi i energjisë reaktive shprehen me kVARh (MVARh).Kapaciteti ose kërkesa ose energjia shprehen me kW (MW).

Termat dhe përkufizimet në këtë kod kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e termave në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

## KAPITULLI II
## STRUKTURA E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

II.1 – Kuadri ligjor dhe rregullator

*II.1.1*Sipas ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE është përgjegjëse për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të pjesëmarrësve të tregut dhe për sigurimin e kontrollit rregullator në tregun shqiptar të energjisë elektrike.

*II.1.2*Ligji për sektorin e energjisë elektrike i jep ERE-s autoritet për miratimin e “Rregullave tëfunksionimit të tregut të energjisë elektrike”.

II.1.3Qëllimi i Rregullave të Tregut është përcaktimi i rregullave transparente dhe jo diskriminuese për tregun shqiptar të energjisë elektrike. ERE do ta monitorojëvazhdimisht

tregun e energjisë elektrike për të siguruar funksionimin e tij jodiskriminues dhe eficient dhe do të mbrojë konkurrencën efektive mes pjesëmarrësve të tij.

*II.1.4*Modelin e Tregut, të miratuar me vendimin nr.244,datë 30.3.2016 nga Këshilli i Ministrave, Rregullat e Tregut së bashku me Kodin e Rrjetit, Kodin e Shpërndarjesdhe Kodin e Matjes,janë pjesë e akteve që rregullojnë tregun e energjisë elektrike.

*II.1.5*ERE do t'i rishikojë këto Rregulla Tregu për t'u siguruar që ato pasqyrojnë zhvillimet e sektorit shqiptar të energjisë elektrike dhe tregut rajonal.

*II.1.6*Të gjitha aspektet e OST-së (dispeçerimi, operimet e tregut dhetë sistemit të transmetimit) duhet të funksionojnë në mënyrë transparente *nën monitorimin*rregullator të ERE-s,*me qëllim* zhvillimin e një tregu komercial të energjisë elektrike.

*II.1.7*Roli i ERE-s në tregun e energjisë elektrike duhet të përfshijë edhe kontrollin e vendosjes së çmimeve nga biznesi monopol, politikat në lidhjeme abuzimin me tregun, miratimin e rregullave, kodeve dhe ndryshimet dhe amendimet e tyre, ngritjen e bizneseve të rregulluara dhe lehtësimin e konkurrencës.

*II.1.8*Nëse ndonjë dispozitë e Rregullave të Tregut është ose bëhet e pavlefshme, e pazbatueshme ose e paligjshme ose deklarohet e pavlefshme, e pazbatueshme ose e paligjshme nga ndonjë gjykatë e juridiksionit kompetent, kjo pavlefshmëri, pazbatueshmëri ose paligjshmëri nuk do të paragjykojë ose ndikojë mbi dispozitat e tjera të Rregullave të Tregut, që do të vazhdojnë të mbeten në fuqi.

II.2 – Pjesëmarrësit e tregut

*II.2.1*Palët e mëposhtme, në varësi të termave dhe kushteve në përputhje me ligjin nr.43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike",VKM nr. 244, datë 30.3.2016 dhe të licencave të tyre përkatëse, do të respektojnëRregullat e Tregut në përputhje me funksionet e tyre.

*II.2.2***OST** –në funksionin eoperatorittërrjetit të transmetimit:

i)Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si: prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara nëligjin nr.43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike";

ii)Operatori i Sistemit të Transmetimit ka të drejtë të faturojë dhe të arkëtojë tarifën e transmetimit, të miratuar paraprakisht nga ERE, në përputhje me metodologjinë e tarifave;

iii)do të menaxhojë dhe operojë sistemin e transmetimit sipas kushteve të Kodit të Rrjetit;

iv)do të zotërojë, mirëmbajë dhe zgjerojë asetet e sistemit të transmetimit;

v)do të përgatisë planifikimin afatgjatë për zgjerimin e sistemit të transmetimit;

vi)do të menaxhojë ndërtimet dhe lidhjet e reja në sistemin e transmetimit;

vii)do të mirëmbajë dhe do të inspektojë periodikisht lidhjet ekzistuese përpërmirësim e tyre;

viii)do të ketë të drejtën për prokurimin e energjisë për mbulimin e humbjeve të transmetimit nga tregtarët.

*II.2.3***OST** –*në funksionin* e operatorit dispeçerues i sistemit:

i)Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për dispeçerimin e energjisë

elektrike nga centralet prodhuese dhe përdorimin e linjave të interkoneksionit, pa ndikuar në detyrimet kontraktore të furnizimit me energji elektrike;

ii)Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet t'i japë prioritet energjisë elektrike të prodhuar nga centralet që përdorin burime të rinovueshme të energjisë elektrike, për aq sa mund ta lejojë siguria e operimit të rrjetit kombëtar të energjisë, duke u bazuar në kritere transparente dhe jodiskriminuese;

iii)Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka të drejtë të blejë dhe të shesë energji elektrike, përveç rastit për mbulimin e humbjeve të energjisë në rrjetin e transmetimit dhe sigurimin e shërbimeve ndihmëse e të balancimit;

iv)do të menaxhojë balancimin fizik të sistemit sipas kushteve të Kodit të Rrjetit;

v)do të ruajë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit, përfshirë flukset ndërshtetërore të energjisë;

vi)do të prokurojë shërbime ndihmëse;

vii)Operatori i Sistemit të Transmetimit shkëmben ose ndan shërbimet e balancimit me operatorët e sistemit të transmetimit të shteteve fqinje për rregullimin e frekuencës brenda rrjetit, në përputhje me marrëveshjet operacionale ndërmjet operatorëve të sistemit të transmetimit të rajonit dhe parashikimeve të ligjit nr.43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike",për promovimin e bashkëpunimit rajonal;

viii)është përgjegjës për devijimet e pakujdes-shme dhe normalizimin e tyre;

ix)do t'u sigurojë informacion të përditshëm të gjitha palëve;

x)do të kryejë gjithë funksionet e tjera që i caktohen nga Rregullat e Tregut;

xi)do të menaxhojë procesin e regjistrimit të gjenerusve, tregtarëve dhe furnizuesve me përgjegjësinë për regjistrimet e matësve dhe konsumin, sipas rastit;

xii)organizon ankandin e kapaciteteve të interkoneksionit;

**xiii)nuk***tregton* dhe nuk zotëron energji ose kapacitet gjenerues.

*II.2.4* ***OST-janë funksionin e saj si operator tregu:***

i)operimi i tregut të energjisë elektrike kryhet nga operatori i tregut, i licencuar nga ERE. Operatori i tregut është struktura përgjegjëse për menaxhimin e tregut të energjisë elektrike dhe përgatitjen e pasqyrave financiare, për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella, për pjesëmarrësit e tregut, pa përfshirë blerjen apo shitjen e energjisë elektrike;

ii)do të jetë përgjegjës për organizimin dhe administrimin e likuidimeve dhepagesave të energjisë elektrike mes pjesëmarrësve të tregut për tregun balancues;

iii)do të organizojë një proces që gjithë palët të përmbushin Rregullat e Tregut;

iv)do të mbajë llogaritë në emër të palëve tregtare për energjinë balancuese dhe shërbimet e siguruara nga OST-ja;

v)do të menaxhojëprocesin e deklarimit të likuidimeve;

vi)do të sigurojë informacion tregu sipas kapitullit XVI të Rregullave të Tregut;

vii)do të kryejë gjithë funksionet e tjera që i caktohen nga Rregullat e Tregut ose me miratimin e ERE-s;

viii)do t'u japë ose do të marrë para nga Palët që kanë siguruar energji balancuese të blerë nga OST-ja;

ix)të nënshkruajë marrëveshjen për pjesë-marrjen në treg për të gjithë pjesëmarrësit e tregut.Marrëveshja për pjesëmarrjen nëtreg propozohet nga OST sh.a. dhe miratohet nga ERE;

x)nuk tregtondhe nuk zotëron energji ose kapacitet gjenerues.

*II.2.5***OSSH** –Operatorii Sistemit të Shpër-Ndarjes:

i) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka në pronësi sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, me qëllim livrimin e saj te klientët, ku kufiri i tij me sistemin e transmetimit është ai i përcaktuar në pikën 2, të nenit 54, tëligjit nr.43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike";

ii)Operon një sistem shpërndarjeje të sigurt, të qëndrueshëm dhe të efektshëm;

iii)do të zotërojë, mirëmbajë dhe zgjerojë sistemin e shpërndarjes në Shqipëri;

iv)do të mbajë një regjistër të vendndodhjeve dhe matësve të konsumit të gjithëklientëve të lidhur me sistemet e shpërndarjes;

v)i siguron, pa pagesë dhe mbi bazën e një marrëveshjeje, çdo furnizuesi të energjisë elektrike, akses në të dhënat e matjes për klientët, me të cilët furnizuesi ka nënshkruar një kontratë furnizimi. ERE përcakton formatin e të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj këtyre të dhënave;

vi)do t'u sigurojë shërbim shpërndarje gjithë klientëve me kushte jodiskriminuese;

vii)do t'u sigurojë shërbim e lidhjes së *prodhuesve dhe klientëve;*

viii)për të mbuluar humbjet në sistemin e shpërndarjes OSSH do të prokurojë energji elektrike nga:

a)prodhuesit me përparësi në përputhje me kontratën tip të miratuar nga ERE;

b)shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik,përsasinë e tepërt të energjisë elektrike;

c)tregtarët nëpërputhje me rregullat dhe procedurat të prokurimit,të miratuara nga ERE.

*II.2.6***Furnizuesi** – si furnizues që blejnë energji elektrike për furnizimin e klientëve fundorë në tregun e brendshëm dhe/ose nëpërmjet importit:

i)do të lidhë kontrata furnizimi të energjisë elektrike me klientët fundorë, me çmime të parregulluara, të negociuara ndërmjet furnizuesit dhe klientit fundor në përputhje me rregullat e tregut dhe kushtet e përgjithshme për furnizim të miratuar nga ERE;

ii)do të kontraktojnë energji elektrike nga tregtarët dhe/prodhuesit ose nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, për aq sa i lejohet vetëm këtij të fundit;

iii)do t'u sigurojë klientëve një informacion të detajuar dhe transparent me shkrim për kushtet kryesore të kontratës. Këto kushte duhet të jenë të drejta dhe të balancojnë interesat e palëve;

iv)përdorin, sipas kushteve të rregulluara, shërbimet e operatorit të tregut, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në bazë të rregullave të tregut, kodeve të rrjetit dhe kontratave përkatëse.

*II.2.7**Furnizuesi i Shërbimit Universal***–si furnizues që i është vendosur detyrimi i

shërbimit universal të furnizimit,si detyrim i shërbimit publik, siguron të drejtën e furnizimit me energji elektrike për një kategori të caktuar të klientëve, në përputhje me kriteret e vendosura në ligjin nr. 43/2015, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një cilësi të caktuar të furnizimit, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese, do të:

i)Blejnë energji elektrike sipas procedurave transparente, jodiskriminuese, bazuar në çmimet e tregut, pavarësisht nëse blerja bëhet në tregun bilateral apo të organizuar.

ii)Blejnë energji elektrike, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike",si detyrim i shërbimit publik, nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti. Sasia e energjisë elektrike përcaktohet në kontratën e rregulluar ndërmjet palëve, që miratohet nga ERE, bazuar në një regjim racional shfrytëzimi të kapaciteteve gjeneruese dhe nivelit historik mesatar vjetor të prodhimit.

iii)Në rastet kur Furnizuesi i Shërbimit Universal nuk mund të sigurojë sasinë e nevojshme nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, sipas përcaktimeve të vendosura në pikën më sipër,Furnizuesi i Shërbimit Universal ka detyrimin që të sigurojë sasinë e nevojshme të energjisë në tregun e parregulluar. Furnizuesi i Shërbimit Universal kompensohet nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, për sasinë e siguruar në tregun e parregulluar, sipas diferencës ndërmjet çmimit të rregulluar të prodhimit të energjisë elektrike dhe çmimit mesatar të bursës hungareze HUPX, për periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë, për produktin/profilin në bandë, siç publikohet në *website*-in e kësaj burse (www.hupx.hu).

iv)Sigurojë energji elektrike për klientët që përfitojnë nga shërbimi universal me çmime të cilat reflektojnë kostot me metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE.

v)T'u ofrojë klientëve të drejtën e kontratave standarde, të përgatitura në bazë të kushteve standarde të furnizimit me energji elektrike, të miratuara nga ERE, në përputhje me nenin 84, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe legjislacionit përkatës për mbrojtjen e klientëve.

vi)Do të mirëmbajë bazën e të dhënave të matësit të klientit dhe do të sigurojë leximin e matësve për proceset e likuidimeve.

vii)Nuk do të shkëmbejë dhe nuk do të regjistrohet sikur zotëron energji ose kapacitet gjenerues.

Shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike,e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, OSSH-ja dhefurnizuesit do të operojnë me licenca të veçanta të lëshuara nga ERE-ja.

*II.2.8* Shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, e ngarkuar me detyrimin eshërbimit publik, do të respektojë Rregullat e Tregut në cilësinë e pjesëmarrësit në treg dhe aktet e tjera rregullatore:

i) do të operojë sipas Kodit të Rrjetit;

ii)do të përcaktojë nivelet e gjenerimit sipas Kodit të Rrjetit dhe Rregullave të Tregut;

iii)do t'i shesë energji elektrike Furnizuesit të Shërbimit Universalderi në atë shkallë sa

kërkohet për të plotësuar ngarkesën e klientëve fundorë sipas miratimit të ERE-s;

iv)do të shesë tepricën e energjisë elektrike pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga furnizimi universal,Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për mbulimin e humbjeve, sipas çmimit mesatar të bursës hungareze HUPX, për periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë, për produktin/profilin në bandë, siç publikohet në *website*-in e kësaj burse dhe përcaktohet, në mënyrë të detajuar, në kontratë. Në këtë rast, sasia e shitur Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të tejkalojë sasinë e energjisë që është e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet. Kontrata ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe prodhuesit të energjisë elektrike miratohet nga ERE;

v)do të japë informacion mbi leximin e matësit për të gjithë energjinë e injektuar në sistemin e transmetimi;.

vi)do të përmbushë gjithë detyrimet e tjera të përcaktuara në Rregullat e Tregut.

*II.2.9***Prodhuesit**–do të respektojnë Rregullat e Tregut në cilësinë e palës tregtare,dhe:

i)do të kontraktojnë në treg të lirë;

ii)do të kontraktojnë për eksportin e energjisë elektrike me çmime tregu;

iii)do të japin informacion mbi leximin e matësve për gjithë energjinë elektrike të shpërndarë ose të nxjerrë nga sistemi i transmetimit.

*II.2.10***Prodhuesit me përparësi** –do të respektojnë Rregullat e Tregut në cilësinë e palës tregtare,dhe:

i)çdoprodhuesienergjisëelektrikenga burimetërinovueshme,mefuqitëinstaluarderinë15MWpërtëgjithacentralete ndërtuara prej shoqërisë, i cili përfiton nga mekanizmi i tarifës fikse të shitjes (*feed-intariff*)ka të drejtë të kontraktojëpërblerjeneenergjisëme kompaninëqëkadetyrimintëblejëenergjinëelektriketëprodhuarngaburimete rinovueshme sipas marrëveshjes së miratuar nga ERE-ja;

ii)do të japin informacion mbi leximin e matësve për gjithë energjinë elektrike të shpërndarë ose të nxjerrë nga sistemi i transmetimit.

*II.2.11***Tregtarët** – si njësi komerciale që tregtojnë energji elektrike:

i)do të blejnë dhe shesin energji elektrike me shumicë;

ii)do të tregtojnë energji elektrike nga importi ose për eksportin ose *prodhuesit*,ose nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik;

iii)do të shesin energji elektrike për eksport.

II.3 – Rregullat dhe detyrimet

*II.3.1*Rregullat e Tregut hyjnë në fuqi dhe bëhen të detyrueshme për të gjitha palët sipas vendimit të Bordit.

*II.3.2*Duke filluar nga data *e hyrjes* në fuqi, secila palë merr përsipër ndaj palës tjetër se do të respektojë dhe do të kryejë detyrimet e veta në përputhje dhe sipas rregullave të tregut.

*II.3.3*Të gjithë pjesëmarrësit e tregut do të licencohen nga ERE për të marrë pjesë në tregun e energjisë elektrike.

KAPITULLI III

PROCESI I REGJISTRIMIT TËPJESËMARRËSVE TË TREGUT

III.1 – Kërkesa përregjistrim

*III.1.1*Personi që dëshiron të marrë pjesë në tregun shqiptar të energjisë elektrike mund t'ia kërkojë këtë gjë me shkrim OST-së, sipas dispozitave të procedurës së regjistrimit të dhënë më poshtë.

*III.1.2.* Procedurat e regjistrimit përgatiten nga OST sh.a. dhe miratohen nga ERE.

III.2 – Tëdhënat për pjesëmarrësit e tregut

*III.2.1*Pjesëmarrësit e tregut do t'i dërgojnë Operatorit të Tregut të OST-së me e-mail ose fax, pasuar nga një shkresë zyrtare, të përcaktuar nga operatori i tregut, një formular regjistrimi për pjesë-marrjen në treg.

*III.2.2*Formulari i regjistrimit duhet plotësuar sipas një modeli të botuar në (Buletinin e OST-së, në faqen e saj në internet) nga OST-ja dhe duhet të përmbajë:

i)emrin e aplikuesit;

ii)qendrën dhe adresën administrative të apli-kuesit, së bashku me detaje kontakti;

iii)telefon, fax, e-mail;

iv)pozicionin në tregun e energjisë elektrike;

v)regjistrimin në organet tatimore*,* regjistrimin e numrit personal të identifikimit;

vi)numrin dhe serinëe licencës të lëshuar nga ERE;

vii)të dhëna bankare (banka, adresa, llogari bankare, kodi bankar);

viii)deklarimin e sasive të energjisë elektrike në MWh, që ka përdorur/gjeneruar aplikuesi një vit para datës së dërgimit të aplikimit përato raste që zbatohet;

ix)listën e personave, të autorizuar për dërgimin dhe konfirmimin e dokumenteve që lidhen me punën operative në tregun e energjisë elektrike;

x)listën e personave të autorizuar për nënshkrimin e kontratave dhe faturave.

*III.2.3*Aplikuesi për pjesëmarrje në tregun shqiptar të energjisë elektrike do t'i bashkëngjisë formularit të regjistrimit dokumentet e mëposhtme:

i)informacionin teknik, të miratuar nga OST-ja për palët dhe për vetëprodhuesit të pajisur me matës tëenergjisë elektrike komerciale (bazuar në Kodin e Matjes), që janë subjekt transaksionesh me çmime tënegociuara lirisht;

ii)një kopje të licencës për gjenerimin e energjisë elektrike ose një kopje të licencës për tregtimin ose furnizimin me energjinë elektrike, nëse është e zbatueshme;

iii)dokumentin, e lëshuar nga OST-ja dhe/ose OSSH-ja*,* që jep akses në rrjetin e transmetimit dhe/ose shpërndarjes së energjisë elektrike, në ato raste që është e nevojshme;

iv)një kopje të bilancit të fundit vjetor të certifikuar nga organet e tatimtaksave;

v)përshkrimin e mjeteve të komunikimit.

*III.2.4*Çdo palë e licencuar, që dëshiron të bëhet pjesëmarrëse në tregun shqiptar të energjisë elektrike, duhet të depozitojë në OST garancinë financiare për të gjitha shërbimet që sigurohen nga OST-ja, të përcaktuara sipas dispozitave të miratuara nga ERE-ja, përfshirë tarifën për alokimin e kapaciteteve.

*III.2.5*OST-ja do të krijojë dhe mbajë Regjistrin Tregtar.

*III.2.6*Pjesëmarrësit e tregut shqiptar të energjisë elektrike të pranuar nga OST-ja sipas dispozitave të këtij seksioni do të regjistrohen në Regjistrin Tregtar. Regjistri Tregtar duhet të për-fshijë për çdo pjesëmarrës të tregut shqiptar të energjisë elektrike, së paku informacionin e mëpo-shtëm:

i)emrin e plotë, adresën zyrtare dhe detaje kontakti të palës së licencuar, të regjistruar si pjesëmarrëse në tregun shqiptar të energjisë elektrike;

ii)datën dhe numrin e marrëveshjes korres-ponduese të pjesëmarrjes në treg;

iii)kodin e identifikimit të pjesëmarrësit në tregun shqiptar të energjisë elektrike;

iv)emrat dhe detajet e kontaktit të gjithë personave të autorizuar për të vepruar në emër të palës së licencuar.

*III.2.7*Çdo pjesëmarrës në tregun shqiptar të energjisë elektrike ka të drejtë të konsultohet me informacionin e Regjistrit Tregtar lidhur me atë pjesëmarrës dhe të kërkojë korrigjimin e çdo gabi-mi të mundshëm.

*III.2.8*Informacioni i Regjistrit Tregtar duhet bërë i disponueshëm për Operatorin e Tregut të OST-së.

III.3 – Regjistrimi në tregun e energjisë elektrike

*III.3.1*Brenda 10 ditëve punë nga marrja e dokumenteve të regjistrimit, OST-ja do të verifikojë të dhënat e aplikimit dhe dokumentet bashkëngjitur, dhe:

i)do të dërgojë njoftim për pranimin e aplikimit për regjistrim në tregun e energjisë elektrike; ose

ii)do të rekomandojë udhëzime dhe kushte të detyrueshme për rregullimin e gabimeve të mundshme në formularët e aplikimit dhe dokumentet bashkëngjitur; ose

iii)do të japë refuzim të deklaruar për regjistrimin e aplikuesve në tregun e energjisë elektrike.

*III.3.2*Njoftimi për pranimin e aplikimit në OST, duhet të përmbajë:

i)numrin identifikues të palës;

ii)shumën e garancisë së depozituar dhe të dhënat në lidhje me bankën ku do të hapet llogaria e veçantë;

iii)kërkesënshtesë të OST-së në fushën e informacionit dhe mjetet e komunikimit të palës, nëse ekzistojnë;

iv)informacion mbi Operatorin e Rrjetit të Transmetimit OST dhe qendrën dheadresën e zyrës dhe atë administrative të OST-së, detajet e kontaktit, adresën, telefonin, fax-in, e-mail-in, taksën e regjistrimit dhe regjistrimin e numrit statistikor të identifikimit; dokumente bankare (bankën, adresën, llogarinë bankare, kodin bankar), përfshirë llogarinë e TVSH-së; listën e personave të autorizuar për dërgimin dhe konfirmimin e dokumenteve lidhur me punën operative në tregun balancues të energjisë elektrike, listën e personave të autorizuar për nënshkrimin e kontratave dhe faturave.

*III.3.3*Pas zbatimit të kërkesave të regjistrimit, OST-ja *do të regjistrojëpjesëmarrësin* në regjistrin e palëve dhe do të nënshkruajëmarrëveshjen e pjesëmarrjes në treg.

*III.3.4*Pas nënshkrimit të marrëveshjes për pjesëmarrjen në treg nga përfaqësuesi i autorizuar ipalës kërkuese, regjistrimi si pjesëmarrës i ri i tregut *bëhet efektive* në datën e

zbatimit të saj.

*III.3.5* OST-ja do të publikojë në faqen e vet të internetit një listë të palëve të regjistruara me informacion mbi emrin, numrin e identifikimit, datën e regjistrimit dhe statusin (tregtues, furnizues që furnizojnë me energji elektrike vetëm vendet e konsumit të tyre, datën e tërheqjes, datën e pezu-llimit, etj.).

*III.3.6*Çdo palë është e detyruar t'i dërgojë informacion operatorit mbi ndryshimin e informacionit të dhënë në regjistrim, brenda 6 ditëve punë nga *ndodhja e ndryshimit.*

*III.3.7*OST-ja do t'i regjistrojë zyrtarisht të gjithë pjesëmarrësit e tregut në tregun e energjisë elektrike.

III.4 – Miratimi rregullator

*III.4.1*Për t'u bërë pjesëmarrës i tregut shqiptar të energjisë elektrike, një aplikues, duhet:

i)të jetë regjistruar nga OST-ja sipas dispozitave tëseksionit të mësipërm;

ii)duhet të ketë licencë nga ERE.

III.5 – Mosmarrëveshja për regjistrimin nga aplikuesi

*III.5.1*OST-ja mund ta refuzojë regjistrimin në tregun e energjisë elektrike, në këto raste:

i)gabime në formularin e regjistrimit dhe dokumentet bashkëngjitur *që nuk janë korrigjuar* brenda 10 ditëve punë;

ii)detyrime ndaj Operatorit të Rrjetit të Transmetimit të OST-së, që nuk janë likuiduar.

*III.5.2*OST-ja nuk do ta regjistrojë një palë në rast mosplotësimi të kushteve brenda termave të përcaktuar*në këto Rregulla.*

*III.5.3*Në rast refuzimi të regjistrimit, aplikuesi mund të nisë një procedurë të re regjistrimi në tregun e energjisë elektrike, 1 muaj pas datës së marrjes së refuzimit nga OST-ja.

*III.5.4*Në rast refuzimi të regjistrimit nga OST-ja, pala ka të drejtë ta kundërshtojë refuzimin me një letër drejtuar ERE-s brenda 10 ditëve punë pas marrjes së tij.

*III.5.5*ERE-ja do të verifikojë nëse arsyet e refuzimit janë të justifikuara dhe do *të marrë* vendimin brenda 15 ditëve punë nga marrja e tij.

*III.5.6*Në rast se vendimi i ERE-s konfirmon se operatori e ka refuzuar në mënyrë të pajustifikuar regjistrimin në tregun e energjisë elektrike, OST-ja është e detyruar që brenda 5 ditëve punë nga marrja e vendimit të ERE-s t'i dërgojë aplikuesit një njoftim për pranimin e formularit së regjistrimit në tregun e energjisë elektrike.

## KAPITULLI IV

## KËRKESA PËR TËRHEQJE, PEZULLIMI DHE PËRFUNDIMI I REGJISTRIMIT

IV.1 – *Kërkesa për tërheqje* nga një pjesëmarrës tregu

*IV.1.1*Një pjesëmarrës tregu mund të tërhiqet nga tregu i energjisë elektrike me iniciativën e tij, bazuar në një njoftim me shkrim, të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i këtij pjesëmarrësi. Njoftimi duhet paraqitur të paktën **3** muaj para datës kur duhet anuluar regjistrimi i pjesëmarrësit të tregut. Pas marrjes së këtij njoftimi, OST-ja duhet të informojë menjëherë të gjithë pjesëmarrësit e tjerë të tregut.

*IV.1.2*Nëse pjesëmarrësi nuk mund t'i plotësojë të gjitha kushtet e Rregullave të Tregut atëherë pjesëmarrësi ose OST-ja duhet të informojnëERE-n brenda 10 ditë pune nga

konstatimi për kushtet.

IV.2 – Pezullimi i veprimtarive tregtare në tregun e energjisë elektrike

*IV.2.1*Pezullimi i veprimtarive tregtare të pjesëmarrësve nga OST-ja*ndodh* – nëse plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

i)pjesëmarrësi i tregut nuk përmbush një ose më shumë kushte të nevojshme për regjistrim si pjesëmarrës tregu (siç përcaktohet në kapitullin III);

ii)pjesëmarrësi i tregut nuk përmbush më kërkesat që lidhen me garancinë financiare, sipas dispozitave të përcaktuara në kapitullin III, ose nuk bën pagesat sipas dispozitave të përcaktuara në kapitullin III;

iii)pjesëmarrësi i tregut nuk respekton marrëveshjen për pjesëmarrjen në treg;

iv)pjesëmarrësi i tregut gjendet vazhdimisht fajtor për mosrespektimin e rregullave të tregut dhe gjithë kodeve të zbatueshme për tregun shqiptar të energjisë elektrike ose marrëveshjen financiare.

*IV.2.2*Nëse pjesëmarrësi i tregut nuk mund të provojë se e ka shmangur shkakun *(shkaqet)* që shkaktoi pezullimin e tij gjatë kësaj periudhe të specifikuar në njoftimin për pezullim, atëherë OST-ja do të procedojë me përfundimin e marrëveshjes për pjesëmarrjen në treg.

*IV.2.3Nëse ky vendim i OST-sëkundërshtohet nga pjesëmarrësiatëherë*pas paraqitjes së ankesës, ERE-ja do të verifikojë nëse arsyet për pezullimin e veprimtarive tregtare janë të justifikuara dhe do ta japë vendimin brenda 15 ditëve punë nga marrja e ankesës.

*IV.2.4*Nëse regjistrimi i pjesëmarrësit të tregut pezullohet, atëherë të gjitha ofertat e mbetura pezull (të reja) të pjesëmarrësit të tregut do të anulohen automatikisht për gjithë periudhën e pezullimit.

IV.3 – Përfundimi i marrëveshjes së pjesë-marrjes në treg

*IV.3.1*OST-ja mund ta përfundojë marrë-veshjen për pjesëmarrje në treg të një pjesëmarrësi tregu në secilin nga këto raste:

i)nëse pjesëmarrësi në treg nuk përmbush më një ose disa nga kushtet e nevojshme për regjistrimin si pjesëmarrës tregu (siç përcaktohet në kapitullin III);

ii)nëse pjesëmarrësi në treg nuk përmbush më kërkesat që lidhen me garancinë financiare, sipas dispozitave të përcaktuara në kapitullin III ose nuk bën pagesat sipas dispozitave të përcaktuara në kapitullin III;

iii)nëse pjesëmarrësi i tregut nuk respekton marrëveshjen për pjesëmarrjen në treg;

iv)nëse pjesëmarrësi në treg gjendet vazhdimisht fajtor për mosrespektimin e rregullave të tregut dhe gjithë kodeve të zbatueshme për tregun shqiptar të energjisë elektrike.

*IV.3.2*Marrëveshja për pjesëmarrjen në treg duhet revokuar automatikisht dhe menjëherë, kur licenca përkatëse e pjesëmarrësit në treg i hiqet nga ERE-ja dhe gjithë ofertat e tij të tregut anulohen automatikisht që nga data e deklaruar në njoftim.

*IV.3.3*Pjesëmarrësi i tregut, marrëveshja për pjesëmarrjen në treg e të cilit ka përfunduar, është përgjegjës për gjithë detyrimet ligjore që OST-ja mund të ketë kundër tij.

## KAPITULLI V

*V.*Kontratat dhe tarifat mes pjesëmarrësve të ndryshëm të tregut:

i)kontratat mes klientëve dhe furnizuesit;

ii)kontratave mes tregtarëve dhe furnizuesit të shërbimit universal;

iii)kontratat mes prodhuesve dhe furnizuesit;

iv)kontratat mes shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publikdhe tregtarëve (për energjinë e tepërt) dhe shkëmbimet;

v)kontratat mes prodhuesve në një anë dhe tregtarëve nga ana tjetër;

vi)kontratat për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes.

Transaksionet dypalëshe në tregun me shumicë të energjisë elektrike legalizohen me kontrata shitblerje të energjisë elektrike për periudha kohore të përcaktuara.

V.1 – Konfidencialiteti i kontratave lirisht të negociuara

*V.1.1*Kontratat e shitblerjes së energjisë elektrike mund të jenë të rregulluara me një përmbajtje minimale të përcaktuar nga ERE ose të jenë të parregulluara, me përmbajtje të përcaktuar nga palët nëpërmjet negociatave direkte, që respektojnë dispozitat e Rregullave të Tregut dhe aktet e tjera të miratuara nga ERE.

*V.1.2* Palët kontraktuese, sasitë e energjisë elektrike dhe çmimet e kontratave të negociuara përbëjnë informacion konfidencial me përjashtim tëdhënave të kontratave të lidhura ngapjesëmarrësit në të tregun e energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik. Për sa kohë që dispozitat e Rregullave të Tregut, Kodit të Rrjetit dhe rregulloreve *përkatëse* të tjera kërkojnë që ky informacion t'i deklarohet OST-së – Operatorit të Tregut, Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit Dispeçer të Sistemit, ky informacion do t'i bëhet i diturOST-së ose OSSH-së,qënuk do t'ia zbulojnë këtë informacion pjesëmarrësve të tjerë të tregut sipas kërkesave të ligjit që aplikohet.

V.2 – Shpallja e kontratave të rregulluara

*V.2.1*Të gjitha kontratat që miratohen nga ERE do të bëhen të disponueshme në faqen e internetit të OST-së. Kontratat e rregulluara janë kontrata të nënshkruara mes pjesëmarrësve të tregut, objekti miratimit nga ERE, me qëllim që të mbrojnë palët kontraktuese nga risku i ndryshimit të çmimit përmbyllës të tregut.

V.3 – Kërkesat dhe efektet e njoftimit të kontratës

*VI.3.1*Të dhënat e kërkuara për njoftimin e kontratave – pjesëmarrësit e tregut do të njoftojnë OST-në për kontratat e tyre duke identifikuar për çdo kontratë sa më poshtë:

i)identifikimin e palëve të kontraktuara;

ii)pikat e livrimit/tërheqjes;

iii)kohëzgjatjen e kontratës;

iv)sasitë e kontraktuara.

*VI.3.2*Këto kërkesa do të zbatohen për gjithë kontratat dypalëshe, përshirë kontratat për eksport/import.

*VI.3.3*Për njoftimet e kontratës do të zbatohet konfidencialitet i rreptë dhe OST-së nuk i

duhet dhënë njoftim për informacion komercial (p.sh., për çmimet).

*VI.3.4*OST-ja do të deklarojë formatin e detajuar për njoftimet e kontratës.

KAPITULLI VI

RREGULLAT PËR NOMINIMET FIZIKE TË PROGRAMIT DHE NJOFTIMET E KONTRATËS

VI.1 – Hyrje

*VI.1.1*Operatori Dispeçer i Sistemit të OST-së duhet të dijë se sa gjenerim është planifikuar dhe cilat njësi do të jenë të *disponueshme,*me qëllim që të planifikojë çdo deficit dhe tepricë që mund të krijohet. Informacioni kërkohet për qëllime të energjisë balancuese (si p.sh., ku duhen vënë në gjendje gatishmërie rezervat shtesë), por nevojitet, gjithashtu, për planifikimin e kushteve të sistemit (ndryshimet e tensionit dhe kufizimet e sistemit).

*VI.1.2* Informacioni sipas paragrafit VI.1.1 do të kërkohet si për gjenerimin edhe për konsumin.Informacioni për konsumin është i nevojshëm kur ngarkesat ndryshojnë në mënyrë të konside-rueshme nga parashikimi i kërkesës së ditës në avancë. Të dhënat për konsumin do të paraqiten në të njëjtën formë si të dhënat e gjenerimit, përveç se me shenja të kundërta.

*VI.1.3*Informacioni fizik duhet trajtuar sipas dy faktorëve të veçantë:

i)parametrat dinamikë që lidhen me karakteristikat fizike të gjeneruesve mund të ndryshojnë nivelet e operimit. Ky informacion përshkruhet si parametrat e të dhënave dinamike të gjeneruesve. Këto të dhëna jepen, gjithashtu, për interkoneksionet;

ii)nivelet e pritshme të prodhimit. Kjo jepet në formën e nominimeve fizike.

*VI.1.4*Të dhënat e parametrave dinamikëmund të ndryshohen në çdo kohë (detaje më tëhollësishme *jepen* në Kodin e Rrjetit). Ato mund të ndryshohen kur kërkesa ose oferta pranohet nga OST-ja që do të përdorë veprime të arsyeshme për t'i marrë parasysh këto ndryshime, por pala do të jetë përgjegjëse për disbalancat (pasojat komerciale) në rast se parametrat ndryshohen.

*VI.1.5*Nominimi fizik i programit i jep OST-së informacion mbi injektimet e pritshme (nivelet e shpërndarjes së gjenerimit dhe importit të inter-koneksioneve) dhe konsumin (ngarkesat), orë pas ore, për ditën në avancë. Forma e nominimit fizik është në terma të shpërndarjes në intervale të përcaktuara 60-minutëshe.

*VI.1.6*Niveli i fundit i nominuar konsiderohet efektiv deri në momentin që ndryshon.

*VI.1.7*Nominimet fizike të interekonjeksionit do të jenë identike në formë, por do të paraqiten në emër të tregtarëve. Pra, nominimi fizik i një tregtari interkoneksioni rrjedh nga nominimi i konfirmuar i interkoneksionit.

VI.2 – Nominimet fizike të programit dhe deklarimi dinamik i të dhënave

*VI.2.1*Qëllimi i rregullave të nominimeve fizike të programit dhe deklarimit të të dhënave dinamike është krijimi i një kuadri për dhënien e informa-cionit lidhur me kapacitetet e prodhimit të *disponueshme* për Operatorin e Sistemit Dispeçer të OST-së, për përgatitjen e programit të prodhimit dhe konsumit dhe për përcaktimin e disponue-shmërisë së

shërbimeve ndihmëse të nevojshme që Operatori i Sistemit të Transmetimit të sigurojë:

i)integritetin e sistemit;

ii)sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike;

iii)kapacitet *e disponueshme* të mjaftueshëm për të siguruar që në çdo moment kërkesa nga sistemi dhe rezerva tëplotësohen;

iv)menaxhimin e kufizimeve në rrjet;

v)përcaktimin e *disbalancave* pas ditës së livrimit.

*VI.2.2*Realizimi fizik i detyrimeve kontraktuale kërkon dorëzimin tek Operatori i Tregut të OST-së të njoftimeve lidhur me gjithë shkëmbimet fizike neto mes palëve individuale (njoftime kontraktuare) ose ndërmjetpalëvepërgjegjësepër balancimin.

*VI.2.3*Nominimi fizik i programit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

i)prodhimin e planifikuar për gjithë njësitë e gjenerimit për të cilat OST-ja ka marrë përgjegjësi balancuese, nga të cilat më vete për prodhimin e agregateve të planifikuara për njësitë gjeneruese që ndjekin ngarkesën;

ii)prodhimin e planifikuar, më vete për çdo njësi gjenerimi të dispeçerueshme të shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti;

iii)konsumin i përgjithshëm planifikuar për gjithë konsumatorët e energjisë elektrike për të cilët OST-ja ka marrë përgjegjësinë e balancimit në mënyrë tëveçantë konsumi i dispecerueshëm;

iv)konsumin e planifikuar për çdo konsumator ose grup-konsumatorësh, me përjashtim të konsumatorit që përfiton nga shërbimi universal i furnizimit;

v)eksportet dhe importet e vendosura me vende të tjera, më vete për çdo shkëmbim/tregti kufitare.

*VI.2.4*Deklarimi dinamik i të dhënave duhet t'i jepet OST-së nga pjesëmarrësit e tregut,gjenerimi dhe furnizimi i së cilës është regjistruar. Kjo përfshin njësinë gjeneruese ose ngarkesat e furnizuara direkt në sistemin e transmetimit.

*VI.2.5*Deklarimi dinamik i të dhënave konsiston në disponibilitetin e tëdhënave (ndërprerjet e planifikuara, koha minimale kyçjes dhe çkyqjes), të dhënat e luhatjeve tëngarkesës (shpejtësia e lëshimit, shpejtësia e çkyqjes), limitet e operimit (vëllimi dhe periudha maksimale e livrimit, niveli maksimal i eksportit ose importit, gjenerimi minimal i qëndrueshëm) dhe kërkesat e njoftimit (njoftimin për të paraqitur ofertën, njoftimin për të paraqitur *kërkesën* dhe njoftimi për kohën e sinkronizimit).

*VI.2.6*Deklarimi dinamik i të dhënave do të vazhdojë të zbatohet për aq kohë sa një njoftim i ri i këtij deklarimi është bërë nga OST-ja. Kjo mund të ndodhë pas pranimit *të ofertës* nga OST-ja. Operatori Dispeçer i Sistemit të OST-së do t'i japë operatorit të tij të tregut gjithë informacionin përkatës.

VI.3 – Format e nominimit fizik të programit

*VI.3.1*Çdo nominim fizik i programit do të paraqitet në këtë formë:

Niveli XX MW **nga**dita/muaji/viti ora:minuta;

Niveli XX MW **deri në** dita/muaji/viti ora:minuta.

*VI.3.2*Ky nomimi fizik do të interpretohet si më poshtë:

i)çdo nominim fizik do të specifikojë livrimin në minuta të caktuara të ditës;

ii)nëse një minutë e caktuar nuk është referuar në nominimin fizik vlera e saj në MW do të përcaktohet nga interpolimi linear i niveleve MW të minutës së fillimit dhe minutës së fundit;

iii)përveç kur zëvendësohet me një tjetër nominim fizik, niveli MW i specifikuar në periudhën e dytë të çdo nominimi fizik do të specifikojë nivelin MW që do të mbahet "për kohë të pacaktuar";

iv)çdo deklaratë e nominimit fizik duhet të ketë një kohë fillimi të njëjtë ose më vonë nga koha e mbarimit të nominimit fizik që mbulon minutat e para të ditës.

*VI.3.3*Kohët e nominuara të fillimit dhe mbarimit të një nominimi fizik mund të mos përkojnë me kohën e fillimit dhe mbarimit të periudhave të marrëveshjeve financiare.

*VI.3.4*Nominimi fizik për ditën e nesërme duhet paraqitur në orën 13:00 të ditës.

*VI.3.5*Çdo njoftim fizik i programit duhet të mbulojë gjithë intervalet e dispeçerimit nga ajo ditë livrimi.

*VI.3.6*Përveç situatave të përmendura në paragrafin *në vijim,* çdo ditë livrimi do të ketë 24 (njëzetekatër) intervale të vazhdueshme dispeçerimi me kohëzgjatje prej 1 (një) orë secili, me intervalin e parë të dispeçerimit që nis në orën [00:00] në ditën e livrimit.

*VI.3.7*Ditën e ndryshimit nga ora verore në orën dimërore, dita e livrimit do të ketë 25 (njëzetepesë) intervale të vazhdueshme dispeçerimi. Ditën e ndryshimit nga ora dimërore në orën verore, dita e livrimit do të ketë 23 (njëzetetre) intervale të vazhdueshme dispeçerimi.

VI.4 – Orari i nominimit fizik të programit dhe përfundimi i afatit (*gate closure*)

*VI.4.1*Orari për operimin të tregut përfshirë programin e nominimit fizik, paraqitjen e kërkesë/ofertës, si dhe pranimin e mëpasshëm të kërkesë/ofertës për një ditë të caktuardo të jetë sipas shtojcës C.

*VI.4.2*Çdo pjesëmarrës tregu do t'i paraqesë Operatorit të Tregut një program ditor në përputhje me procesin e programimit të ditës në avancë, siç specifikohet në Kodin e Rrjetit. Operatori i Tregut OST do të përcaktojë formatin e programit ditor.

*VI.4.3*Programi ditor i çdo pjesëmarrësi në treg do të jetë një program 24 orësh, që siguron nivele e sasisë për gjithë nivelin e gjenerimin/blerjeve dhe konsum/shitjet e energjisë për çdo periudhë të marrëveshjes financiare përfshirë humbjet.

*VI.4.4*Programi ditor i OST-së do të përfshijë një program për gjithë transaksionet e pjesë-marrësve të tregutpër të cilat OST-ja ka përgjegjësi balancimi.

*VI.4.5*Programi ditor i OST-së përmban sasi orare, për:

i)gjenerimin e shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti;

ii)gjenerimin e prodhuesve;

iii)gjenerimin e prodhuesve me përparësi;

iv)transaksionet e energjisë elektrike nga furnizuesit;

v)transaksionet e energjisë elektrike nga tregtarët;

vi)programin e import/eksportit për tregtarët dhe furnizuesit;

vii)konsumin e klientëve fundore nga Furnizuesi i Shërbimit Universal dhe OSSH-ja;

viii)energjinë e nevojshme për të mbuluar humbjet nëshpërndarje nga OSSH-ja;

ix)detyrimin për të mbuluar humbjet e sistemit, të cilat vlerësohen në përputhje me procedurat e Kodit të Rrjetit.

*VI.4.6*Përfundimi i afatit – pasi Operatori i Tregut të *OST-së* ka informuar Operatorin e Dispecerimit OST të Sistemit të Dispeçerimit, lidhur me programin ditor të miratuar, Operatori i Sistemit të Dispeçerimit OST mund të paraqesë programe të korrigjuara *të balancimit* (rinominime) deri në përfundim tëafatit sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Rrjetit.

*VI.4.7*Operatori i Tregut OST do t'i publikojë të gjitha kufizimet e parashikuara në sistem që mund të ndikojnë mbi shumat e transaksioneve të nominuara nga pjesëmarrësit e tregut sipas procedurave të përshkruara në Rregullat e Tregut dhe Kodin e Rrjetit.

*VI.4.8*Operatori i Tregut OST do të regjistrojë për çdo njësi gjenerimi për intervale kohe njëorëshe dhe sasinë e energjisë së rinominuar, siç përsh-kruhet në paragrafët e mësipërm.

## KAPITULLI VII
## RREGULLAT PËR TREGUN BALANCUES

VII.1 – Përshkrim i përgjithshëm dhe përkufizime

*VII.1.1*Tregu balancues i energjisë elektrike shërben, për:

i) të siguruar energji për diferencën ndërmjet ngarkesës dhe nominimit fizik në program sipas kontratave të përfunduara;

ii) për të siguruar rezervë shtesë për sistemin elektroenergjetik - duke i kërkuar gjeneruesve që të mbajnë rezerva shtesë për të shmangur një kufizim në sistemin elektroenergjetik;

iii) për të llogaritur çmimin për disbalancat.

*VII.1.2*Operatori i Sistemit Dispeçer OST kontrollon dhe menaxhon çdo disbalancë në sistem, duke përdorur mundësitë e tregut balancues në përputhje me këto Rregulla Tregu dhe siçpërshkruhen në Kodin e Rrjetit.

*VII.1.3*Dispecerimi në kohë reale ose kontrolli i bilancit të fuqisë për sistemin shqiptar të energjisë elektrike do të kryhet sipas procedurave tëOperatorit të Sistemit Dispeçer OST.

*VII.1.4*Gjenerimi, shkëmbimi dhe konsumi i programuar janë objekt i çdo modifikimi nga Operatori i Sistemit Dispeçer OST.

*VII.1.5*Kushtet e emergjencës– për ruajtjen e sigurisë së sistemit të energjisë elektrike në kushte emergjence, Operatori i Sistemit Dispeçer OST mund të nxjerrë udhëzime emergjence për të gjitha palët. Kjo mund të kërkojë veprime jashtë tregut të energjisë elektrike. Çdo pale i kërkohet të ndërmarrë gjithë veprimet e arsyeshme për të përmbushur udhëzimet e emergjencës.

*VII.1.6* Me qëllimin e sigurimit të qëndrue-shmërisë së sistemit elektroenergjitik, Operatori i Sistemit Dispeçer OST ka autoritetin dhe përgjegjësinë për ruajtjen eshkëmbimeve të energjisë me sistemet fqinje.

VII.2 – Pjesëmarrësit nëtregun e balancimit

*VII.2.1* Çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike konform legjislacionit në fuqi.

*VII.2.2* Pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike mund të rregullojnë përgjegjësinë për balancimin, nëpërmjet një kontrate me Operatorin e Sistemit të Transmetimit, duke marrë statusin e palës përgjegjëse për balancim ose duke nënshkruar një kontratë për transferimin e përgjegjësisë së balancimit ndaj një pale tjetër përgjegjëse për balancimin, duke u bërë pjesëtar i një grupi balancues, në përputhje me rregullat e tregut.

*VII.2.3* Operatori i tregut është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella për disbalancat e shkaktuara nga pjesëmarrësit e tregut.

*VII.2.4* Operatori i Sistemit të Transmetimit siguron shërbimet e balancimit të sistemit prej ofruesve të këtij shërbimi në tregun e balancimit, në përputhje me rregullat e balancimit, të miratuara nga ERE.Deri në krijimin e tregut të balancimit tarifat për realizimin e shërbimit të balancimit vendosen sipas metodologjisë sipas metodologjisë të përcaktuar nga ERE.

*VII.2.5*Pjesëmarrësit në tregun e balancimit duhet të përmbushin rregullat e tregut për tregun e balancimit.

*VII.2.6* Pjesëmarrësit në tregun e balancimit qëjanë duke siguruar shërbime ndihmëseduhet tëpërmbushin termat e marrëveshjeve të tyre për shërbimet ndihmëse.

VII.3 –Kërkesat dhe ofertat; parashtrimi i kërkesave dhe i ofertave

**Planifikimi mujor**

*VII.3.1*OST-ja duhet të nxjerrë parashikimet e përditësuara brenda orës 10:00 përpara ditës së dispeçerimitnë kohë reale, që udhëzon tregun e energjisëlidhur medisbalancate pritshme. Jo më vonë se 10 ditë para fillimit të një muaji të caktuar gjatë vitit nëavancë, OST-ja do të hartojë një plan mujor operimi për operimin e sistemit energjetik shqiptar bazuar në informacionin mujor të përditësuar të siguruar nga pjesëmarrësit e tregut.

*VII.3.2*Plani mujor i operimit do të përmbajë për atë muaj:

i)kërkesën për kapacitet dhe plotësimin nga gjenerimi lokal;

ii)profilet e pritshme tipike javore dhe ditore të kurbës së ngarkesës gjatë muajit për ditët e punës dhe pushimit, dhe kurbat tipike mujore të ngarkesës për të shtunat dhe të dielat;

iii)planin ditor dhe mujor të mbylljeve të programuara të njësive të gjenerimit;

iv)planifikimin e kuotës së ujit të liqenit të Fierzës në ditën e parë të muajit;

v)energjinë e importuar të programuar;

vi)planin mujor të mbylljeve të programuara të njësive gjeneruese;

vii)planin për shërbimet ndihmëse gjatë muajit – çdo njësi gjeneruese nga lista e gjeneruesve për sigurimin e shërbimeve ndihmëse duhet t'i sigurojë OST-së të dhënat e mëposhtme:

a) kufirin e kapacitetit rezervë të ofruar në MW, për rritje/ulje dhe shpejtësia e ndryshimit në MW/min;

b)*shkallën*e rritjes/rënies së rezervës energjetike në MW/min për muajin në avancë, të ndarë në javë operimi;

viii)metodologjia dhe formula për llogaritjen e kërkesave të sistemit për shërbimet ndihmëse dhe kompensimi për një muaj përshkruhet në Kodin e Rrjetit;

ix)vlerësimin e operimeve të pritshme në terma të qëndrueshmërisë operative dhe sigurisë së sistemit energjetik dhe masat e pritshme gjatë muajit për forcimin e sigurisë dhe qëndrueshmërisë sipas nevojës.

*VII.3.3*Deklarimi dinamik i tëdhënave mund të ndryshohet nëçdo kohë, përveçndonjë kufizimi në Kodin e Rrjetit. Ato mund të ndryshohen pavarësisht se njëkërkesë ose ofertëështë pranuar.Për të ndihmuar OST-në në përgatitjen e planit mujor të operimit, pjesëmarrësit e tregut që marrin shërbime transmetimi do të përgatisin planin për përdorimin e rrjetit të transmetimit jo më vonë se 20 ditë para fillimit të muajit në formën e deklaruar në Kodin e Rrjetit.

*VII.3.4* Një kërkesë ose ofertëështë për një devijim specifik nga pozicioni fizik i nominuar dhe ndryshimi në energjinë e livruar.

VII.4 – Dita në avancë dhe rregullimet brenda ditës

*VII.4.1* Pas përgatitjes së planit javor për "Javën e energjisë", OST-ja mund të bëjë rregullime të mëtejshme në programin e gjenerimit dhe importit për të përballuar kërkesat ditore për energji.

*VII.4.2*Të gjitha Palët kanë detyrimin t'i sigurojnë OST-së informacion në kohën e duhur për çdo faktor që mund të ndikojë përmbajtjen e parashikimit të ditës në avancë dhe, veçanërisht, shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, do tëkryejë veprime të arsyeshme për t'i siguruar OST-së vlerësimin më të mirë të kërkesës orare për ditën në avancë para se OST-ja të bëjë parashikimin e vet fillestar të ditës në avancë.

*VII.4.3*Në rast se parashikimet e përditësuara të ditës në avancë tregojnë se nevojitet energji elektrike shtesë, më tepër nga sa mund të sigurohet nga gjithë burimet e *disponueshme,* OSSH-ja do të zbatojë ndërprerjet e nevojshme në rrjetin e shpërndarjes.Veç kësaj, ndërprerjet mund të jenë, gjithashtu, të nevojshme nëse ngarkesat gjatë një dite të caktuar i tejkalojnë parashikimet e ditës në avancë.

*VII.4.4* OST-ja dotë dispeçerojë në mënyrë ekonomike *njësitë* gjeneruese për të plotësuar ngarkesat, dhe do të zbatojë transaksionet e importit dhe eksportit, bazuar në planifikimin javor të rishikuar të periudhës së ditës në avancë, përshkruar në Kodin e Rrjetit.

## KAPITULLI VIII
## RREGULLAT PËR SHËRBIMET NDIHMËSE

VIII.1 Hyrje

*VIII.1.1* OST-ja mban përgjegjësi të plotë për prokurimin dhe menaxhimin e shërbimeve ndihmëse.Shërbimet ndihmëse përfshijnë kontrollin e frekuencës, rregullimin eenergjisë aktive nëpërmjet rezervave primare, sekondare dhe terciare, dhe rregullimin e tensionit dhe fuqisë reaktive. Kodi i Rrjetit jep gjithë detajet teknike për shërbimet ndihmëse.

*VIII.1.2* Gjithë njësitë gjeneruese, të lidhura me sistemin e transmetimit, duhet të marrin pjesë në rregullimin primar.

*VIII.1.3*Rezerva primare – Njësitë gjeneruese do të sigurojnë rregullimin primar të frekuencës dhe energjisë aktive me shpenzimet e tyre sipas kërkesave teknike të vendosura në Kodin e Rrjetit.

*VIII.1.4*Rezerva sekondare – *për rregullimin e energjisë sekondare/aktive çdo gjeneruesi i* kërkohet të japë kufirin e energjisë rezervë të ofruar në MW dhe *shkallën* e rritjes/rënies së energjisë në MW/min.

*VIII.1.5*Rezerva terciare – kjo rezervë përdoret për të ndihmuar rregullimin sekondar, duke krijuar një kufi të kërkuar rregullimi për të.

*VIII.1.6*Rregullimi i tensionit dhe energjisë reaktive – me qëllim që të ruhet siguria dhe integriteti i sistemit elektroenergjitik, OST-ja menaxhon nivelet e tensionit në sistemin e transmetimit dhe i mban ato brenda kufijve të pranueshëm të dhënë në Kodin e Rrjetit.

*VIII.1.7*Kodi i Rrjetit përcakton detyrimin e gjeneruesve dhe aftësitë teknike të njësive të tyre gjeneruese për sigurimin e shërbimeve ndihmëse.

VIII.2 – Plani vjetor iprokurimit të shërbimeve ndihmëse

*VIII.2.1* Kodi Teknik i Rrjetit përcakton detyrimin e pjesëmarrësve të tregut për të treguar në balancën vjetore të energjisë elektrike aftësitë teknike të gjeneratorëve të tyre për sigurimin e shërbimeve ndihmëse.

*VIII.2.2* ERE-ja do të miratojëçmimet e rregulluara për njësitë e gjenerimit të ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik.

*VIII.2.3* Operatori iSistemit Dispeçer të OST-së do të vlerësojë sasitë e kërkuara të gjithëshërbimeve ndihmëse për vitin që vjen dhe do të përcaktojë shumën financiare përsigurimin e çdo shërbimi individual në bazë vjetore, si dhe shumën financiare totale për sigurimin e gjithë shërbimeve ndihmëse të nevojshme.

*VIII.2.4* Çdo vit, bazuar në informacionin e marrë nga pjesëmarrësit e tregut, Operatori iSistemit Dispeçer OST do të përgatisë një listë të njësive gjeneruese për sigurimin e shërbimeve ndihmëse, që do të miratohet nga ERE.

*VIII.2.5* OST-ja do të kontraktojë ose *do të bëjëmarrëveshjepër*sigurimin e këtyre sasive dhe llojevetë shërbimeve ndihmëse, sipas nevojës dhe sipas Kodit të Rrjetit.

*VIII.2.6* Gjatë kontraktimit ose rregullimit të sigurimit të shërbimeve ndihmëse, OST-ja do të blejë ose marrë shërbime ndihmëse nga burimet më ekonomike të disponueshme.

*VIII.2.7* Kur të marrë në konsideratë burimet më ekonomike të disponueshme, OST-ja do të ketë parasysh sasinë, natyrën, diversitetin dhe qëndruesh-mërinë e shërbimeve ndihmëse të disponueshme në atë kohë për blerje dhe kërkesat e saj sipas Kodit të Rrjetit.

*VIII.2.8* Siguruesit e shërbimeve ndihmëse do të plotësojnë kushtet e marrëveshjeve të tyre për shër-bime ndihmëse për t'i siguruar Operatorit të Sistemit Dispeçer OST kontrollin e fuqisë dhe transmetimin e energjisë elektrike nëpërmjet sistemit energjetik.

VIII.3 – Rishikimi periodik teknik dhe komercial i shërbimeve ndihmëse

*VIII.3.1* OST-ja do të vlerësojë nivelet e shërbimeve ndihmëse që do të kërkohen duke ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

*VIII.3.2* Çdo qershor OST-ja do t'u dorëzojë palëve dhe palëve të tjera të interesuara një dokument konsultimi në të cilin do të hetojë:

i)nëse niveli i vlerësuar mbetet i përshtatshëm lidhur me kërkesën aktuale dhe kërkesën e pritshme të dimrit;

ii)tarifat e mundshme të importit dhe eksportit ose energjisë gjatë dimrit në avancë;

iii)njësitë gjeneruese që ka të ngjarë të jenë të *disponueshme* për sigurimin e shërbimeve ndihmëse.

*VIII.3.3* Në muajin korrik OST-ja do t'i paraqesë ERE-s një raport që detajon:

i)metodologjinë që OST-ja ka zbatuar për vlerësimin e niveleve të shërbimeve ndihmëse të kërkuara dhe vlerën e vlerësuar (në lekë), që kanë këto shërbime ndihmëse për sigurinë e sistemit;

ii)një justifikim për çdo ndryshim që OST-ja propozon për zbatim përveç atyre të përdorura vitin e mëparshëm.

VIII.4 – Shlyerja e kostos së shërbimeve ndihmëse

*VIII.4.1* Shlyerja e kostos së shërbimeve ndihmëse përshkruhet në tarifat e shërbimeve ndihmëse.

*VIII.4.2* Tarifa e shërbimeve ndihmëse përgatitet sipas metodologjisë së tarifës së shërbimeve ndihmëse dhe miratohet nga ERE-ja.

*VIII.4*.3 Çdo njësi gjenerimi që ka siguruar shërbim ndihmës do të kompensohet me çmim të rregulluar.

## KAPITULLI IX
## RREGULLAT PËR LLOGARITJEN E DISBALANCAVE

IX.1 – *Disbalancat* kundrejt nominimeve fizike të programit

*IX.1.1*Disbalancimi i energjisë – disbalancimi i energjisë përcaktohet për llogarinë e njësive gjene-ruese dhe për llogarinë e furnizimit.

i)Për llogarinë e gjenerimit, disbalancimi i energjisë llogaritet, si:

Energjia e matur e llogarisë së gjenerimit minus pozicionin e kontratës së gjenerimit plus gjithë vëllimet e livrimit të kërkesës për gjithë njësitë balancuese të regjistruara në llogari minus gjithë vëllimet e livrimit të ofertave për gjithë njësitë balancuese të regjistruara në llogari.

ii)Për llogarinë e furnizimit, disbalancimi i energjisë vjen nga:

Energjia e matur e llogarisë së furnizimit minus pozicionin e kontratës së furnizuesit plus gjithë vëllimet e livrimit të kërkesës për gjithë njësitë balancuese të regjistruara në llogari minus gjithë vëllimet e livrimit të ofertave për gjithë njësitë balancuese të regjistruara në llogari.

*IX.1.2*Çmimii energjisë së disbalancimi është çmimi me të cilin energjia e balancimit do të paguhet.

*IX.1.3 a)*Çmimi i energjisë balancuese llogaritet për çdo muajme çmimin maksimal të blerjes së energjisë elektrike në tregun e parregulluarnga OSSH-ja plus 10% të këtij çmimi

ose në mungesë të tijme çmimin e blerjes së energjisë elektrike ngaOSSH-ja prej prodhuesve me përparësi, miratuar nga ERE plus 20% të këtij çmimi, për disbalancat negative.

*b)* OST sh.a. çdoditë do të bëjë shumën aritmetike të 24 orëve të disbalancavenegative të shkaktuara nga çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike dhe çdo muaj do të përgatisë faturën mujore si shumë aritmetike e çdo 24 orëve të disbalancavenegative dhe do t'i dërgojë pjesë-marrësve të tregut faturat përkatëse.

*c)* OST sh.a. do të bëjë shumën aritmetiketë 24 orëve të disbalancavepozitive të shkaktuara nga çdo pjesëmarrës tregu ienergjisë elektrike dhe çdo muaj do të përgatisë faturën mujore si shumë aritmetike e çdo 24 orëve të disbalancave pozitive, të cilat do të jenë me çmimin e gjenerimit që ka detyrimin e shërbimit publik dhe do t'i dërgojë pjesëmarrësve të tregut faturat përkatëse. OST /Operatori i Tregut njofton pjesëmarrësit e tregutpër disbalancat e tyre për ditën paraardhëse brenda orës 12:00 të ditës pasardhëse.

*d)* Gjeneruesit e energjisë elektrike, që nuk janë përfshirë në vendimin e Këshillit tëMinistrave, sipas nenit 99, pika 4, të ligjit të sektorit të energjisë elektrike, do të jenë përgjegjës për mbulimin e kostove të shkaktuara nga disbalancat.

*e)*Gjeneruesi i ngarkuar me sigurimin e balancimit nuk është subjekt i trajtimit të disbalancave.

*f)*Brenda datës 5 të muajit n+1,OSSH-ja i dërgon OST-sëçmimin mesatar të ponderuar të importeve të energjisë elektrike të realizuar prej tij për muajin n. OST sh.a. brenda datës 10 të muajit n+1 u dërgon faturat pjesëmarrësve të tregut. Në llogaritjen e pagesave OST sh.a. do të përdor kursin mesatar të këmbimit tëeuro/lekë të muajit n të publikuar nga Banka e Shqipërisë*)*.

IX.1.4. OST sh.a. publikon në faqen e saj zyrtare të internetit çmimin mesatar (të ponderuar), qëështë aplikuar për disbalancat.OST sh.a. deri në datën 25 të muajit n+1 do tëdërgojë në ERE një raport përmbledhëspër disbalancat dhe çmimin e aplikuar përvlerësimin e këtyredisbalancave për muajin n.

IX.1.5 Çdopjesëmarrës i tregut do të marrëpërgjegjësipër balancimin përkundrejt OST-sëpërgjithë prodhimin, blerjen, importin, eksportin, shitjen ose konsumin e tij.

IX.1.6 OST-ja i faturon çdo muaj çdopjesëmarrësi tregu përgjegjëspërdisbalancat e shkaktuara vlerën të llogaritur sipas çmimit të miratuar nga ERE dhe disbalancave përkatëse të tyre.

IX.1.7 Llogaria e të ardhurave të balancimit të energjisë vjen nga shumëzimi i energjisë së balancimit me çmimin e balancimit të aplikueshëm për periudhënpërkatëse.

IX.1.8 Nuk do të jetë subjekt i disbalancave pjesëmarrësi i tregut i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, i cili është sigurues i shërbimit të balancimit.

IX.2 – Njoftimi i mosmarrëveshjes

*IX.2.1*Nëse Operatori i Tregut OST i ka dhënë një njoftim pjesëmarrësit të tregut lidhur me shkeljen e Rregullave të Tregut dhe Kodit të Rrjetit dhe pjesëmarrësi nuk bie dakord me njoftimin, atëherë pjesëmarrësi brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditëve punë duhet t'i sigurojë ERE-s njoftim me shkrim për mosmarrëveshjen dhe një kopje Operatorit tëTregut të OST-së.

*IX.2.2*ERE-ja do ta pranojë këtë njoftim mosmarrëveshje dhe do të mbajë një seancë dëgjimore lidhur me mosmarrëveshjen duke i lejuar çdo pale të paraqesë dokumente që lidhen me njoftimin.

*IX.2.3*ERE-ja do të zgjidhë mosmarrëveshjen sipas rregullave dhe procedurave të miratuara prej saj.

## KAPITULLI X
## RREGULLAT PËR ALOKIMIN E KAPACITETIT TË INTERKONEKSIONIT

*X.1.1**OST-ja***do të alokojë kapacitetet e interkoneksionit në përputhje me rregullat e miratuara nga ERE.

## KAPITULLI XI
## RREGULLAT E LIKUIDIMEVE

XI.1 – Përgjegjësitë e likuidimeve për *disbalancat*

*XI.1.1*OST-ja kontrollon dhe menaxhon çdo disbalancim në sistemin energjetik në kohën *reale,* duke përdorur aftësitë balancuese të tregut të energjisë elektrike.

*XI.1.2Disbalancat* e kontratës duhen matur si diferenca mes energjisë së matur dhe energjisësë kontraktuar për intervale kohore korresponduese.

*XI.1.3*Për çdo *gjenerues*dhe/ose palëpërgjegjësepër balancim, OST-ja përgatit një deklaratë (ditore, javore dhe mujore), përshirë gjithë informacionin për disbalancimet.

XI.2 – Afatet kohore të likuidimeve

*XI.2.1*Mbledhja dhe verifikimi i të dhënave nga OST-ja do të përfundojë brenda 5 ditëve nga dita e dispeçerimit.

i)leximi i matësit – dita e tregtimit plus një ditë;

ii)llogaritja e sasive orare të matura– dita e tregtimit plus pesë ditë.

*XI.2.2*Veprimet pas përfundimit të muajit të tregtimit, janë:

i)muaji i tregtimit plus 6 ditë – OST-ja do t'i dërgojë çdo pjesëmarrësi të tregut një raport mujor me të dhëna orare të matura dhe të llogaritura për muajin e tregtimit;

ii)muaji i tregtimit plus 8 ditë – pjesëmarrësit mund t'i paraqesin OST-së një ankesë *për* raportin mujor lidhur me saktësinë e të dhënave;

iii)muaji i tregtimit plus 10 ditë – nëse OST-ja e konsideron të justifikuar kërkesën, do të nxjerrë një raport të ri mujor dhe do *t'ua* shpërndajë atë pjesëmarrësve. Në rast se OST-ja e konsideron pretendimin si të pajustifikuar, njofton pjesë-marrësin dhe vazhdon me marrëveshjen financiare në përputhje me raportin mujor të vlefshëm.

*XI.2.3*Në rast mosmarrëveshje, pjesëmarrësi është i detyruar të paguajë shumën korresponduese në përputhje me udhëzimet për nxjerrjen e faturave të nxjerrë nga OST-ja;mosmarrëveshja nuk vonon ekzekutimin e detyrimeve. Pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes, do të bëhet korrigjimi i faturës, po të jetë e nevojshme.

XI.3 – Likuidimet për periudhën e transicionit

*XI.3.1*Për çdo llogari *prodhimi* dhe llogari furnizimi duhet përcaktuar një sasi e matur. Kjo bëhet në ditën e *punës* që është*në ose pas ditës së*7*-tëpas ditës së* vlerësimit të likuidimeve.

*XI.3.2*Llogaritja e prodhimit – energjia e matur në llogarinë e gjeneruesit del nga mbledhja (nga çdo njësi balancuese e regjistruar në llogari) e diferencës mes leximeve orare të matësit në fund të periudhës së likuidimit me atë të marrë në periudhën fillestare. Për interkoneksione importuese merret mbledhja e vlerave në fund tëçdo ore të linjave tëinterkoneksioneve.

*XI.3.3*Për njëllogari gjenerimi, energjia *disbalancuese*del nga:

i)energjia e matur e llogarisë së gjenerimit **minus**;

ii)sasia në kontratën egjeneratorit **plus**;

iii)gjithë vëllimet e livrimit të ofertave të propozuara për gjithë njësitë balancuese të regjistruara në llogari **minus**;

iv)gjithë vëllimet e livrimit të realizuara për gjithë njësitë balancuese të regjistruara në llogari.

*XI.3.4*Llogaritja e furnizimit – ka dy stade llogaritje të llogarive të furnizimit.

i)Për çdo sistem matës të furnizimit, ku kërkohen të dhëna *matjeje* për çdo periudhë likuidimi, energjia e matur e llogarisë së furnizimit del nga shuma e:

a) çdo njësie balancuese të regjistruar në llogari;

b) diferencës mes leximit të matësit në fund të periudhës së likuidimit me atë të marrë në fillim;

c) shumës së vlerave të konfirmuara *të inter-koneksionit të nominuar*.

ii)Për rrjetin OSSH, energjia e matur OSSH del nga matja në kufijtë mes rrjetit të transmetimit dhe sistemit të shpërndarjes duke marrë leximin në fund të periudhës së marrëveshjes financiare dhe duke e krahasuar atë me leximin në fillim. Nga kjo zbritet energjia e matur nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti.

*XI.3.5*Për llogarinë e furnizimit, energjia disbalancuese del nga:

i) energjia e matur e llogarisë së furnizimit **minus**;

ii) programin sipas kontratës së furnizuesit **plus**;

iii) gjithë vëllimet e kërkesës së livrimit për gjithë njësitë balancuese të regjistruara në llogari **minus**;

iv) gjithë vëllimet e livrimit të realizuara për gjithë njësitë balancuese të regjistruara në llogari.

XI.4 – Përmbajtja e raportit të likuidimeve

*XI.4.1*Operatori i Tregut OST do të përcaktojënjë format standard për gjithë raportet e likui-dimeve–për deklaratat e llogarive të gjeneruesve dhe furnizuesve. Pas miratimit të ERE-s, Operatori i Tregut OST do ta bëjë këtë raport standard të disponueshëm për të gjitha palët e interesuara.

*XI.4.2*Më vete për çdo pjesëmarrës dhe për çdo ditë, Operatori i Tregut OST do të përgatisë një raport ditor të likuidimeve, që përfshin gjithë vlerat që duhen të debitohen ose kreditohen në llogarinë e likuidimeve që i përket pjesëmarrësit. Ky raport përfshin të paktën

informacionin e mëposhtëm:

i)vlerën neto sipas programit ditor sipas kontratës;

ii)sasinë totale dhe vlerën që i korrespondon shumës së shitjeve të pjesëmarrësit;

iii)sasinë totale dhe vlerën që i korrespondon shumës së blerjeve të pjesëmarrësit;

iv)vlerat që rezultojnë nga zbatimi i *tarifave*të OST-së;

v)vlerat që rezultojnë nga zbatimi i çdo takse tjetër;

vi)vlerën neto totale që duhet debituar ose kredituar në llogarinë e Operatorit tëTregut OST që i përket pjesëmarrësit.

*XI.4.3*Operatori i Tregut të *OST-së* i transmeton çdo pjesëmarrësi deklaratën ditore të marrëveshjes financiare, para mbarimit të ditës së tregtimit.

## KAPITULLI XII
## RREGULLAT PËR FATURIMIN DHE PAGESËN

XII.1 – Të përgjithshme

*XII.1.1*Faturat do t'u shpërndahen pjesë-marrësve një herë në muaj nga Operatori i Tregut OST. Të gjitha detyrimet do të paguhen sipas kontratavedypalëshepër muajinparaardhës. Faturat do të mbulojnë çështjet e mëposhtme:

i)llogaritë e pjesëmarrësve për rregullimin balancues;

ii)llogaritë dhe vlerësimet sipas marrëveshjevepër disbalancat;

iii)pagesat përtarifën e transmetimit dhe përdorimit të sistemit, përfshirë shërbimet ndihmëse, në përputhje me metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të miratuar nga ERE-ja.

*XII.1.2*Faturat do të dorëzohen normalisht ditën e 10-të të muajit kalendarik pasardhës. Palët tregtare kanë 10 ditë për të paguar faturën.

*XII.1.3*OST-ja mund të përcaktojë procedura për specifikimin e formatit të faturës dhe gjithë të dhënave ndihmëse.

*XII.1.4*Operatori i Tregut OST kryen llogaritjet për marrëveshjen ditore të tregut të energjisë elektrike për çdo pjesëmarrës. Operatori i Tregut OST përcakton vlerën e marrëveshjeve financiare ditore nëpërmjet agregimit të sasive të shumëzuara me çmimet për gjithë transaksionet e përfunduara nga pjesëmarrësi me OST-në në ditën korres-ponduese siç specifikohet në Kodin e Rrjetit.

XII.2 – Faturat për llogarinë e marrëveshjes së disbalancimit

*XII.2.1*Operatori i Tregut OST përgatit më vete për çdo muajdite dhe për çdo pjesëmarrës një faturë për deklaratën e marrëveshjes së disbalancimit.

*XII.2.2*Një zë i veçantë i faturës do të përmbajë llogaritëpër disbalancat sipas marrëveshjes së disbalancimit. Kjo përfshin të gjithë vlerat që duhen debituar ose kredituar në llogarinë sipas marrëveshjes së disbalancimit të pjesëmarrësve për çdo ditë.

*XII.2.3*Operatori i Tregut OST ia i dërgondeklaratën e realizimit tëdisbalancavepër

muajin n çdo pjesëmarrësi brenda 10 ditëve pas përfundimit të muajit,përfshirëvlerën përkatëse qëçdopjesëmarrësTREGU duhet të paguajë ose të marrë.

XII.2.4 OST-ja i dërgon në të njëjtën ditëgjeneruaesit të ngarkuar për balancim deklaratën e realizimit tëdisbalancave dhe faturën përkatëse, e cila përmban vlerën që ky i fundit do të përfitojë për të gjithëenergjinë balancuese të ofruar gjatë muajit N për rastet e inbalancave pozitive ose pagesën e vlerës në rastet e inbalancave negative tëpjesëmarrësve të tregut.

XII.3 – Faturat për pagesat *e disbalancave*dhe përdorimit të sistemit të transmetimit

*XII.3.1*OST-ja përgatit faturat për gjithë pjesëmarrësit për disbalancat dhe përpërdorimin e rrjetit të sistemit të transmetimit.

XII.4 – Mosmarrëveshjet mbi faturat dhe pagesat

*XII.4.1*Nëse një palë tregtare kundërshton *nëmënyrë të drejtë* shumën e një fature, shuma e padebatueshme do të paguhet në çdo rast në datën e duhur. Në rastin e shumave për të cilat detyrohet llogaria e palës përkatëse ose që idetyrohen kësaj llogarie, pagesa duhet bërë sipas faturimit me shumën e debatueshme subjekt të kthimit *ex post (tëmëparshëm).*

*XII.4.2*Pagesat e pakryeralidhur me çdo paqartësi ose mbipagesë në faturë grumbullojnë një interes prej _0,5__% në ditëpërçdo ditë vonesë.

*XII.4.3*Nëse rezultati i paqartësisë së faturës nuk është idrejtëose OST-ja nuk ka vepruar në mënyrë të arsyeshme në menaxhimin e paqartësisë së faturës ose në llogaritjen e pagesës së debatueshme atëherë OST-ja detyrohet t'i paguajëpjesëmarrësit të tregut një interes prej _0,5_ % në ditë tëvlerës sëdiferencës sëfaturës së paguar prej tij përperiudhën nga kryerja e pagesës dhe zgjidhja e mosmarrëveshjes.

*XII.4.4*Interesi është i pagueshëm në shuma që përfaqësojnë diferencën mes shumës së paguar dhe shumës korrekte pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe do t'ipaguhet OST-së ose *nga* OST-ja, sipas rastit.

*XII.4.5*Pas zgjidhjes së paqartësisë së faturës, pagesa duhet bërë brenda 3 (tri) ditëve punë nga zgjidhja e mosmarrëveshjes. Pas kësaj date, interesi mbi shumën e papaguar do të akumulojë interesa prej __0,5_% në ditë.

## KAPITULLI XIII
## SIGURIA E FURNIZIMIT

XIII.1 – Detyrimet e sigurimit të furnizimit me energji elektrike

*XIII.1.1*Ligji nr. 43/3015,"Për sektorin e energjisë elektrike"dhe VKM nr.244,datë 30.3.2016,përcaktojnë përgjegjësitë dhe detyrimet që *lidhen me* sigurinë e furnizimit me energji elektrike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Kodi i Rrjetit përshkruan me detaje implementimin e sigurisë së furnizimit dhe detyrimet që lidhen me aktivitetet e shërbimit publik, si: gjenerimi,transmetimi, shpërndarja e energjisë elektrike dhe operimi i sistemit elektrik.

*XIII1.2*Rregullat nuk duhet të jenë diskri-minuese apo të parashikojnë detyrime të paarsyeshme ndaj pjesëmarrësve ekzistues e të rinj të tregut.

*XIII 1.3*Pjesëmarrësit e tregut duhet të veprojnë në përputhje me masat dhe rregullat e

sigurisë së furnizimit dhe do të jenë përgjegjës për sigurinë e furnizimit me energji elektrike në përputhje me veprimtarinë që ushtrojnë.

*XIII.1.4*Çdo detyrim i vendosur ndaj një të licencuari që kryen aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes ose furnizimit të energjisë elektrike, në përputhje me Rregullat e Sigurisë së Furnizimit, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, do të konsiderohet detyrim i shërbimit publik.

XIII.2 – Pezullimi i tregut të energjisë elektrike, pjesërisht ose krejtësisht, nga Operatori i Sistemit

*XIII.2.1*Pezullimi i veprimtarive tregtare dhe veprimet *qëkërkohen*:

i)në kushtet e forcës madhore si p.sh., një gjendje e jashtëzakonshme e sistemit elektro-energjetik, OST-ja mund ta pezullojë tregun e energjisë elektrike;

ii)mungesa e gjenerimit të energjisë elektrike shkaktuar nga humbja e importit ose pamundësia e gjenerimeve për të përballuar kërkesën për ngarkesë;

iii)në këto kushte, Operatori i Sistemit Dispeçer të OST-së do të informojë Operatorin e Tregut OST dhe Operatorin e Rrjetit të Transmetimit, ERE-n, gjithë pjesëmarrësit e tregut dhe gjithë palët rajonale të interkonjektuara;

iv)në këto kushte, OST-ja mund të refuzojë të pranojë ose të japë parashikime ose çfarëdolloj paraqitje;

v)Operatori i Sistemit Dispeçer të OST-së do të informojë sa më shpejt të jetë e mundur Operatorët e Tregut dhe Rrjetit të Transmetimit, ERE-n, gjithë pjesëmarrësit e tregut dhe gjitha palët rajonale të interkonjektuara që tregu i energjisë elektrike është vënë ose do të rivihet në punë dhe kohën kur kjo ndodh ose do të ndodhë.

*XIII.2.2* Kompensimi i pjesëmarrësve të tregut gjatë pezullimit të tregut të energjisë elektrike

i)pezullimi i tregut të energjisë elektrike nuk anulon asnjë kontratë përfshirë pranimet tashmë të bëra të *kërkesave dhe ofertave;*

ii)çdo pranim tashmë i bërë i kërkesave ose ofertave për një periudhë marrëveshje financiare gjatë së cilës ka ndodhur pezullimi do të quhet si kontratë e vlefshme dhe Operatori i Tregut OST do të *bëjë* vlerësimet e arsyeshme për energjinë që do të ishte livruar sipas kushteve të tregut të energjisë elektrike;

iii)gjatë pezullimit të tregut të energjisë elektrike çmimii rregulluar i ballancimit do të përdoret për energjinë e livruar;

iv)kërkesat dhe ofertat e papranuara ende do të injorohen për kohëzgjatjen e pezullimit të tregut të energjisë elektrike dhe çmimet e këtyre kërkesave dhe ofertave nuk do të jenë të vlefshme gjatë pezullimit.

## KAPITULLI XIV
## MATJA

XIV.1 – Dispozita tëpërgjithshme mbi matjen

XIV.1.1Standardi minimal teknik, projektues dhe operativ i sistemeve matëse, i përdorur

për matjen e energjisë së livruar ose të konsumuar nga pjesëmarrësit e tregut dhe për të nxjerrë pozicionin e disbalancimeve që rezulton nga instruktimi është ai i përcaktuar në Kodin e Matjes. Kodi i Matjes luan rol në përcaktimin e kërkesave për matjen komerciale me qëllim operimin e tregut të energjisë elektrike.

XIV.2 –Llogaria e matësit të *gjeneruesve*

XIV.2.1 Nëllogarinë e regjistruar nga OST-ja përfshihet energjia e futur në sistem nga gjeneruesit dhe importuesit sipas marrëveshjeve përkatëse. Energjia e matur nga gjeneruesit dhe energjia e importuar regjistrohet për çdo periudhë likuidimi.

XIV.3 – Llogaria e matësit të fuqisë për ngarkesën

*XIV.3.1*Llogaria e matësit tëngarkesës regjistrohet nga një furnizues ose tregtar për qëllime të likuidimeve. Sasia e matur e energjisë së konsumuar dhe e eksportuarregjistrohet në këto llogari për çdo periudhë likuidimeve.

*XIV.3.2* Për çdo llogari të matësit ngarkese do të mbahet informacioni i mëposhtëm:

i)numri i referencës së sistemit matës i caktuar nga OST-ja;

ii)identiteti i furnizuesit;

iii)identiteti i çdo matësi fizik, të cilit i kërkohet të regjistrojë flukse energjie.

*XIV.3.3*OST-ja do të operojë një sistem elektronik që shqyrton automatikisht matësit e sistemit të furnizimit sipas Kodit të Matjes.

XIV.4 – Profilizimi i konsumit të energjisë

*XIV.4.1* OST-ja do të ndërmarrë veprimet e arsyeshme për të siguruar saktësinë e gjithëparashikimeve që ajo bën për kërkesën dhe do të mbështetet në këtë informacion meqë disponon modele të parashikimit të motit dhe analizat e modeleve historike të konsumit të energjisë elektrike, si dhe informacionin specifik që mund të sigurojnë Palët, por OST-ja nuk do të jetëpërgjegjëse për saktësinë ose jo të parashikimeve të kërkesës së ditës në avancë tëbëra prej tyre.

*XIV.4.2* Të gjitha palët kanë detyrimin t'i japin OST-së informacion në kohën e duhur mbi çdo faktor që mund të ndikojë mbi përmbajtjen e parashikimeve të kërkesës dhe, veçanërisht, Furnizuesi Publik me Shumicë do të ndërmarrë veprime të arsyeshme për t'i siguruar OST-së vlerësimin më të mirë të kërkesës orare për ditën në avancë para se OST-ja të bëjë parashikimin e vet fillestar për kërkesën e ditës në avancë.

XIV.5 – Vetëprodhuesit

*XIV.5.1* Për vetëprodhuesit do të përcaktohen të paktën tri vlera të ndryshme matje në çdo pikë interkoneksioni:

i)prodhimi *bruto* i vetëprodhuesit;

ii)konsumi *bruto* i vetëprodhuesit;

iii)sasia neto e energjisë elektrike të livruar tek ose të marrë nga sistemi i transmetimit OST ose OSSH-ja.

*XIV.5.2*Sasia neto e energjisë elektrike të livruar në sistemin e transmetimit OST ose e marrë OSSH do të përdoret për përcaktimin e disbalancimeve dhe për likuidimet.

*XIV.5.3*OST-ja do të operojë një sistem elektronik që *kontrollon* automatikisht gjeneratorin ose matësit e njësisë gjeneratore.

XIV.6 – Prodhuesit

*XIV.6.1*Prodhuesitmund të kenë marrëveshje për matjen për një matës që regjistron për likuidimet shumatorin e gjenerimit dhe konsumit neto për një periudhë kohe të caktuar. Një sistem matës mund të ketë më shumë se një matës fizik për të matur shumatoren neto të energjisë së prodhuar.

*XIV.6.2*OST-ja do të operojë një sistem elektronik që kontrollon automatikisht gjeneratorin ose matësit e njësisë gjeneratore në secilin sistem matës që përdoret për furnizimin e të dhënave të matjes për çdo periudhë likuidimesh.

XIV.7 – Klienti ilidhur me rrjetin e shpërndarjes

*XIV.7.1* Klientët që nuk përfitojnë nga shërbimi i furnizimit universalkanë të drejtë të *lidhin* kontrata me çmime lirisht të negociueshme për furnizimin me energji elektrike.

*XIV.7.2 Kur* ERE përcakton se një klient, i cili nuk përfiton nga shërbimi universal i furnizimitdhe pajisja për regjistrimin e të dhënave përkatëse deri në *një moment kohe* nuk është instaluar, OST-ja ose (sipas rastit) OSSH-ja do të ndërmarrë menjëherë hapat për të siguruar instalimin e kësaj pajisje sa më shpejt që të jetë e mundur.

XIV.8 – Detyrimet lidhur më energjinë e regjistruar

*XIV.8.1* Palëve do t'u kërkohet të regjistrojnë marrëdhëniet dhe konfigurimet mes të dhënave të matura, në mënyrë që të kryhet shumatori përkatës për ta lehtësuar tregun e energjisë elektrike sipas procedurave përkatëse.

XIV.9 – Përgjegjësia për leximin e matësit

*XIV.9.1* OST-ja do të operojë një sistem elektronik që *kontrollon* automatikisht matësit në çdo sistem matës të përdorur për furnizimin e të dhënave të matjes për çdo periudhë likuidimi.

*XIV.9.2* OST-ja do t'i ndërmarrë këto veprime kur është e arsyeshme për të vënë në zbatim dhe operuar sistemet për shqyrtimin e matësve dhe do të komunikojë gjithë të dhënat e matjes lidhur me periudhën e likuidimit në afatin kohor të kërkuar.

*XIV.9.3* OST-ja do të publikojë dhe mbajë çdo muaj, në faqen e internetit të OST-së, njëlistë që identifikon çdo sistem matës për të cilin kërkohet *kontroll* automatik dhe/ose komunikim, por që nuk është instaluar dhe nuk operon.

*XIV.9.4* Lista:

i)do të identifikojë sistemin matës në fjalë;

ii)do të identifikojë llogarinë e furnizimit ose llogarinë e njësisë së gjenerimit *në të cilënështë vendosur* sistemi matës;

iii)do të identifikojë periudhën e likuidimeve;

iv)do të specifikojë arsyet se pse nuk është instaluar dhe nuk operon sistemi automatik;

v)do të japë çdo informacion tjetër që Operatori i Tregut OST-ja, e përcakton si të përshtatshëm.

XIV.10 – Defekti ose shkëputja e sistemit matës të *gjeneruesit*

*XIV.10.1 Kurnë një* sistem matës i njësisë gjeneruesetë dhënat ematura të të cilit nuk janë transmetuar, OST për qëllimet e likuidimit do të vlerësojë sasinë e livruar ose (sipas rastit) e konsumuar të energjisë, bazuar në të dhënat historike dhe në të dhënat e mekanizmave të

tjerë matës gjatë periudhës përkatëse.

*XIV.10.2 Kur në një*sistem matës i prodhuesëve, një vetëprodhues ose një klienti fundor që nuk përfitonnga shërbimi universal i furnizimittë dhënat e matura të të cilit nuk janë transmetuar, OST-ja për qëllimet e likuidimit do të vlerësojë sasinë e livruar ose (sipas rastit) e konsumuar të energjisë, bazuar në të dhënat historike dhe në të dhënat e mekanizmave të tjerë matës gjatë periudhës përkatëse dhe përcaktimeve të Kodit të Matjes.

XIV.11 – Defekti ose shkëputja e sistemit matës për kërkesën

*XIV.11.1 Kur në*sistemin matës të konsumatorit të dhënat e matjes të të cilit nuk janë transmetuar për shkak të defektit ose rënies së matësit për kërkesën, OST-ja për qëllimet e likuidimit do të vlerësojë sasinë e livruar ose (sipas rastit) e konsumuar të energjisë, bazuar në të dhënat historike dhe në të dhënat e mekanizmave të tjerë matës gjatë periudhës përkatëse.

XIV.12 – Përgjegjësia për regjistrat e matjes

*XIV.12.1* Qëllimi i regjistrit të matjes është regjistrimi i pikave të lidhjes dhe pikave të matjes të rrjetit.

*XIV.12.2* Regjistrii Matjes do të jetë përgjegjësi e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit OST, që do të përgjigjet për përditësimin, mirëmbajtjen dhe administrimin, si dhe për sigurinë dhe konfi-dencialitetin e tij. Para çdo modifikimi që do të ndikojë mbi leximet, Operatori i Rrjetit të Transmetimit OST duhet të informojë Operatorët e Tregut dhe të Sistemit Dispeçer të OST-së. Regjistri i matjes së FurnizuesitUniversalështë përgjegjësi e OSSH-së.

*XIV.12.3* Operatori i Rrjetit të Transmetimit OST është i detyruar të përcaktojë gjithë të dhënat e nevojshme për matjen.

*XIV.12.4*Regjistri matës duhet të përmbajë të dhënat minimale të mëposhtme:

i)Detaje mbi pikat e lidhjes dhe pikat e matjes (vendndodhja, pala përgjegjëse, kodet e identi-fikimit dhe të dhëna të tjera përkatëse) përfshirë gjithë klientët e kualifikuar;

ii)Pajisjet matëse të *instaluara* (prodhuesin, tipin, modelin, numrin serial, datën e prodhimit dhe kategorinë e matësit të instalimit; gjithë të dhënat përkatëse për specifikimet fizike dhe teknike, standardet, energjinë e vlerësuar dhe maksimale, gjithë informacionin që lidhet me testimin dhe datën e fillimit të matjes, që përfshin rezultatet e testit dhe certifikatat dhe datat e kalibrimeve dhe të dhëna të tjera përkatëse);

iii)informacion mbi komunikimin e të dhënave (numrat e telefonave për mbledhje të dhënash, informacion mbi tipa të tjerë komunikimi për mbledhje të dhënash, tipat, numrat serialë, specifikimet teknike të pajisjeve të komunikimit dhe të dhëna të tjera përkatëse).

XIV.13 – Transferimi i llogarisë së matësit ose llogarisë së konsumit të matësit

*XIV.13.1*Kur një furnizues kërkon të bëhet furnizuesi i një klienti që nuk përfiton ngashërbimiuniversali furnizimit, atëherëfurnizuesi, duhet të:

i)të njoftojë Operatorin e Rrjetit të Shpër-ndarjes, mbi:

a) identitetin e sistemit të matjes të planifikuar për transferim

b) datën e planifikuar për transferimin e furnizimit, që nuk duhet të jetë më pak se njëzet 20 ditë pune pas datës së njoftimit

ii)të garantojë Operatorin e Tregut OST që ka ose do të ketë një kontratë të veçantë për furnizimin e këtij klienti të kualifikuar.

*XIV.13.2*Brenda pesë 5 ditëve punë pas marrjes së njoftimit të dorëzuar OSSH-së, OSSH-ja do të njoftojë furnizuesin aktual mbi transferimin e planifikuar, përfshirë identifikimin e furnizuesit të ri.

*XIV.13.3*Nëse nuk ka kundërshtim ndaj transferimit të planifikuar të furnizimit dhe datës së transferimit, regjistri i matësit të furnizimit do të kalojë nga OSSH-ja te furnizuesi i ri, i cili do të jetë furnizuesi i regjistruar nga fillimi i asaj dite. OSSH-ja do të njoftojë Operatorin e Tregut OST, furnizuesin aktual (të mëparshëm) dhe furnizuesin e planifikuar mbi kryerjen e këtyre ndryshimeve.

*XIV.13.4* Operatori i Tregut OST që do të sigurojë të dhënat e leximit të matësit nga llogaria përkatëse e matësit përfshihet në llogarinë e furnizimit të furnizuesit të ri nga fillimi i ditës së referuar në njoftim.

## KAPITULLI XV
## GARANCITË

*XV.1*Operatori i Tregut OST ka të drejtë t'u kërkojë palëve të depozitojnë garanci para se pala përkatëse të regjistrohet si pjesëmarrëse e tregut shqiptar të energjisë elektrike.

*XV.2*Garancitë e depozituara nga pala e regjistruar si pjesëmarrëse e tregut shqiptar të energjisë elektrike mund të kufizojnë:

i)vëllimin total financiar të ofertave që një pjesëmarrës mund të paraqesë në tregun e ditës në avancë;

ii)madhësinë maksimale të përcaktuar nga Operatori i Tregut OST për ofertat dhe kërkesat e energjisë;

iii)madhësinë maksimale të përcaktuar nga Operatori i Tregut OST për eksportet dhe importet.

*XV.3*Garancitë e depozituara nga pjesëmarrësi do të jenë të barabarta me 5% të programit maksimal fizik mujor, të parashikuar nga këta pjesëmarrës, shumëzuar me 10 lekë/kWh ose ekuivalentin e saj në monedhë tjetër të pranuar. Letra e krediti, duhet, gjithashtu, të pranohet në vend të depozitës.

*XV.4*Operatori i Tregut OST do të përpunojë procedurat për përcaktimin e tipit dhe garancive të nevojshme të kërkuara, si dhe procedurat për realizimin dhe verifikimin e depozitës së garancisë nga palët.

*XV.5*Procedurat për llogaritjen e garancisë dhe kontrollin e depozitave është subjekt imiratimit nga ERE. Pas miratimit nga ERE, Operatori i Tregut OST do ta bëjë këtë informacion të disponueshëm për të gjitha palët.

*XV.6*Gjithë pjesëmarrësit e tregut kanë detyrimin tëpërmbushin detyrimet ndaj OST-së për shërbimet e *saj,* përfshirë tarifën e transmetimit dhe shërbimetndihmëse.

*XV.7*Furnizuesi Universal do të hapë një llogari qendrore në një bankë tregtare shqiptare për pagesat që i detyrohet OST-së, shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike e ngarkuar me

detyrimin eshërbimit publik dhe furnizuesve të tjerë.

*XV.8*Furnizuesi Universal ka detyrimin parësor për të përmbushur gjithë pagesat ndaj OST-së, shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike e ngarkuar me detyrimin eshërbimit publik për energjinë e konsumuar nga klientët e tij tariforë dhe OSSH-së për energjinë e kërkuar për të mbuluar humbjet e shpërndarjes.

*XV.9*ERE, nëse kërkohet, mund të miratojë çdo garanci tjetër për pagesa me para në dorë për t'u mbajtur si llogari dorëzanie ose një garanci nga një bankë e njohur ose mënyra të tjera garancish nga investitorët që janë të barabarta me kërkesat e sigurisë.

## KAPITULLI XVI
## SHKËMBIMI I TË DHËNAVE DHE I INFORMACIONIT

*XVI.1*Në komunikimin me OST-në, palët i përmbahen Kodit tëRrjetit, që specifikon kërkesat SCADA, kohën e përgjigjes dhe sigurinë.

*XVI.2*Komunikimi për marrëveshjen finan-ciare nuk kërkon të njëjtin nivel përgjigje të menjëhershme dhe shumica e tij është komunikim pas ngjarjes.

*XVI.3*Çdo palë do të jetë përgjegjëse për sigurimin dhe mirëmbajtjen (me shpenzimet e saj) e telefonit, lidhjes me internetin dhe faksimilen.

*XVI.4*Të dhënat dhe informacioni i mëposhtëm do të jenë *të disponueshme* për të gjitha palët:

*XVI.5*Parashikimi i kërkesës ose i ngarkesës:

**i)Shoqëria e prodhimit të energjisë elektrikee ngarkuar me detyrimin eshërbimit publik**, OSSH-ja dhe, sipas rastit, furnizuesit do t'i sigurojnë OST-së parashikimin e ngarkesës për javën në avancë për klientët e tyre në bazë orare. Ky parashikim ngarkese do të përditësohet në bazë të ditës në avancë para mbylljes së portës.

**ii)Shoqëria e prodhimit të energjisë elektrikee ngarkuar me detyrimin eshërbimit publik** do t'i sigurojë OST-së parashikimin për reduktimin e ngarkesës së javës në avancë në bazë orare. Ky parashikim i reduktimit të ngarkesës do të përditësohet bazuar në ditën në avancë para mbylljes së portës.

iii)OST-ja do të *bëjë*parashikime të javës në avancë për kërkesën e pritshme orare. Kjo kërkesë do të përditësohet në bazë të ditës në avancë para mbylljes së portës. Ky parashikim do të përfshijë humbjet e OST-së dhe OSSH-së.

iv)Këto raporte do të publikohen në faqen e internetit të OST-së pasi të bëhen të disponu-eshme.

*XVI.6*Parashikimi i gjenerimit ose injektimit:

i)Gjeneruesitdhe importuesit do t'i sigurojë OST-së parashikimin e prodhimit të pritshëm nga njësitë gjeneruese livrimit/furnizimit (ose injektimit në sistem) të pritshëm në bazë orare/ditore për një javëpërpara që do të përditësohet në ditën përpara mbylljes së afatit (*gate closure*) dhe në kohë reale.

ii)Afati i paraqitjes do të jetë sipas Kodit të Rrjetit dheprocedurave përkatëse të OST-së.

iii)Këto raporte do të publikohen në faqen e internetit të OST-së pasi të bëhen të

disponueshme.

*XVI.7*Programet e livrimit përinter-koneksionet (*nominime*):

i)pjesëmarrësit që pritet të kenë tregti import/eksporti do të paraqesim parashikimin e nominimit në bazë të ditës në avancë sipas procedurës së duhur të OST-së;

ii)këto programe do të publikohen në faqen e internetit të OST-së sipas procedurës përkatëse të OST-së dhe rregullave të tregut (subjekt i mosdeklarimit të informacionit konfidencial siç parashikohet në*këto* Rregullat e Tregut).

*XVI.8*OST-ja do të *bëjë* informacionin e mëposhtëm dhe do ta publikojë në faqen e vet të internetit:

i)parashikojë kërkesatpër rezervë të llogaritura me formulën e Kodit të Rrjetit;

ii)parashikimin për shërbimet ndihmëse të llogaritura me formulën e Kodit të Rrjetit;

iii)gjenerimin e *disponueshëm* – kapacitetin e pritshëm total *të disponueshëm* të gjenerimit;

iv)kërkesën maksimale të pritshme dhe kërkesën mesatare orare në MW për çdo muaj në vitin kalendarik;

v)vlerësimet e humbjeve në sistemin e transmetimit në GWh në bazë javore;

vi)vlerësimet e kufizimeve të paparashikuara në sistem në GWh në bazë javore;

vii)detaje mbi çdo situatë të parashikuar kur dhe ku do të kufizohet furnizimi.

## KAPITULLI XVII
## INFORMACIONI I TREGUT

XVII.1 – Të përgjithshme

*XVII.1.1* OST-ja do t'i bëjë të disponueshme çdo pjesëmarrësi në treg çdo informacion lidhur me operimin e tregut të energjisë elektrike të papërcaktuar si konfidencial ose komercialisht të ndjeshëm dhe mund të caktojë një pagesë të arsyeshme për të mbuluar koston për sigurimin e këtij informacioni.

*XVII.1.2* Informacioni i tregut mund të mbahet nga një numër palësh, për shembull nga OST-ja, OSSH-ja ose Furnizuesit, që do të kenë një numërinformacionesh teknike si rezultat i përgjegjësive të tyre për operimin e sistemit, përfshirë p.sh.: të dhënat e parashikimit të kërkesës, disponueshmërinë e gjenerimit (i planifikuar dhe i paplanifikuar),disponueshmërinë e rrjetit dhe interkoneksionit, ngarkesën dhe investimet e ardhshme.

*XVII.1.3* Formati dhe përmbajtja e ofertave të tregut, si dhe shkalla e çmimit për tregun e energjisë elektrike, do të vendoset nga Operatori i Tregut OST dhe do të miratohet nga ERE. Ky informacion do të bëhet i disponueshëm nga OST-ja për gjitha palët e interesuara.

XVII.2 – Përhapja e informacionit dhe raportimi

*XVII.2.1* Raportet javore të likuidimeve të OST-së – ditën e parë (1) financiare të çdo jave kalendarike, Operatori i Tregut OST do të lëshojë një deklaratë të llogarive për javën e mëparshme kalendarike për çdo palë që ka një llogari likuiduese të tregut.

*XVII.2.2* Deklarata e llogarisë përfshin të paktën informacionin e mëposhtëm lidhur mellogarinë likuiduese korresponduese të tregut:

i)emrin e zotëruesit të llogarisë;

ii)balancën e llogarisë likuiduese të tregut në fillim të javës kalendarike të mëparshme;

iii)çdo vlerë të debituar ose të kredituar në llogarinë likujduese të tregut si rezultat i detyrimeve të pagesave ose të drejtave të shlyerjes,të vendosura sipas rregullave të likuidimeve;

iv)balancën e llogarisë likuiduese të tregut në fund të javës së mëparshme kalendarike.

*XVII.2.3* Raportet mujore likuiduese të OST-së – ditën financiare të 15 (pesëmbëdhjetë) të çdo muaji kalendarik, Operatori i Tregut OST nxjerr një deklaratë të llogarive për muajin e kaluar kalendarik për çdo palë që ka një llogari likuiduese tregu.

*XVII.2.4*Deklarata e llogarisë përfshin të paktën informacionin e mëposhtëm lidhur me llogarinë korresponduese të likuidimit të tregut:

i)emrin e pronarit të llogarisë

ii)balancën e llogarisë likuiduese të tregut në fillim të muajit të mëparshëm kalendarik

iii)çdo vlerë të debituar ose të kredituar në llogaritë e likuiduese të tregut si rezultat i detyrimeve të pagesave ose të drejtavetë shlyerjes, të vendosura sipas rregullave të likuidimeve;

iv)balancën e llogarisë së likuidimeve të tregut në fund të muajit të mëparshëm kalendarik.

XVII.3 – Politika e informimit

*XVII.3.1* OST-ja duhet të*kryejë veprime të arsyeshme* për të siguruar se u jep gjithë palëve informacion të mjaftueshëm. Ajo do të publikojë në faqen e vet të internetit vlerësime të tashme dhe të ardhshme të sistemit të energjisë elektrike me detaje të mjaftueshme dhe *në* intervale të vendosura me ERE-n me qëllim që të sigurojë që të gjitha palët të informohen si duhet.

*XVII.3.2* OST-ja është përgjegjëse për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të mbledhura për vlerësimin e sistemit energjetik dhe për qëllime operative. Këto të dhëna mund të jenë komercialisht të ndjeshme dhe konfidencialiteti do të respektohet si për çdo marrëveshje dypalëshe.

## KAPITULLI XVIII
## ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

XVIII.1 – Procedura e përgjithshme

*XVIII.1.1* Në rast mosmarrëveshje mes palëve lidhur me Rregullat e Tregut dhe Kodin e Rrjetit siç përcaktohen në këto dokumente, palët do të përpiqen me mirëbesim të zgjidhin mosma-rrëveshjen lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Rregullat e Tregut dhe Kodin e Rrjetit.

*XVIII.1.2*Në rast se palët dështojnë në arritjen e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, ajo do tëzgjidhet nga ERE sipas ligjit për sektorin e energjisë, Rregullave të Tregut dhe Kodit të Rrjetit.

XVIII.2 – Njoftimi i mosmarrëveshjes

*XVIII.2.1*ERE do të pranojë çdo kërkesë me shkrim për zgjidhjen e një mosmarrëveshje

që vjen direkt ose indirekt nga sjellja jotransparente dhe diskriminuese e palëve aktive në tregun e energjisë elektrike dhe që ajo autorizohet ta zgjidhë nga ligji për sektorin e energjisë.

XVIII.3 – Procesi i zgjidhjes së mosma-rrëveshjeve

*XVIII.3.1* ERE do t'i trajtojë dhe zgjidhe çështjet e ngritura në kërkesë ose në ankesë sipas rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s.

*XVIII.3.2*ERE rezervon të drejtën për të punësuar ekspertë të jashtëm të fushës për trajtimin e çështjeve të veçanta.

XVIII.4 – Mosmarrëveshjet lidhur me likui-dimet

*XVIII.4.1* Në rast mosmarrëveshje, pjesëmarrësi është i detyruar të paguajë shumënkorresponduese sipas udhëzimeve për dhënien e faturave të nxjerrë nga OST-ja. Pasi merret vendimi përfundimtar për mosmarrëveshjen do të bëhet korrigjimi i faturës, nëse nevojitet.

*XVIII.4.2* Apelime kundër përmbajtjes së raportit të transaksioneve pranohen vetëm në rast tëgabimeve që rezultojnë nga veprimet e Operatorit të Tregut OST.

*XVIII.4.3* Çdo apelim ndaj raportit të transaksionit i duhet dorëzuar OST-së jo më vonë se 2 (dy) ditë pune pas dërgimit të raportit të transaksionit nga OST-ja.

*XVIII.4.4* OST-ja do të informojë pjesëmarrësin e tregut të energjisë elektrike mbi pranimin ose hedhjen poshtë të apelimit përkatës jo më vonë se 2 (dy) ditë pune pas afatit të specifikuar në paragrafin e mëparshëm. Në rast pranimi, OST-ja do t'i dërgojë pjesëmarrësit të tregut të energjisë elektrike një raport transaksioni të korrigjuar.

*XVIII.4.5* Nëse, gjatë intervalit kohor të specifikuar në paragrafin e mëparshëm, pjesë-marrësi i tregut të energjisë elektrike nuk paraqet asnjë apelim ndaj raportit të transaksionit të marrë prej tij, atëherë ato konsiderohen si të pranuara.

*XVIII.4.6* Asnjë apelim i paraqitur nuk e shkarkon pjesëmarrësin përkatës të tregut të energjisëelektrike nga përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga transaksionet e diskutueshme.

## KAPITULLI XIX
## PROCEDURAT PËR AMENDIMET E RREGULLAVE TË TREGUT

XIX.1 – Të përgjithshme

*XIX.1.1*Këto rregulla tregu mund të ndryshohen sipas procedurave të ERE-s.

XIX.2 – Administrimi i Rregullave të Tregut

*XIX.2.1*OST-ja është administratori i Rregullave të Tregut dhe përgjigjet për vënien në zbatim të tyre.

*XIX.2.2*OST-ja do të shqyrtojë periodikisht Rregullat e Tregut. Për këtë qëllim, OST-ja, së bashku me pjesëmarrësit e tregut, do të ngrijnë komitetin për rishikimin e Rregullave të Tregut. Asnjë rishikim apo modifikim i Rregullave të Tregut nuk mund të kryhet pa diskutime të mëparshme me ERE-n dhe pa miratimin e ERE-s.

*XIX.2.3*Komiteti i rishikimit do të menaxhohet nga OST-ja.

*XIX.2.4*Komiteti i rishikimit do të mbikëqyrë vazhdimisht zbatimin e Rregullave të

Tregut, do të marrë iniciativa për rishikimin e tyre, do të marrë në konsideratë çdo kërkesë për modifikime të paraqitur nga palët dhe do t'ia dërgojë ERE-s për rishikim dhe miratim.

**Propozimet për amendimet e Rregullave**

*XIX.2.5 Këto rregulla janë objektrishikimi me iniciativën e ERE-s apo mekërkesë të OST-së.* Palët mund të ngrenë me OST-në çështje lidhur me Rregullat e Tregut.

*XIX.2.6* OST-ja do ta sjellë çështjen në vëmendje të ERE-s.

XIX.3 – Procesi i amendimit të Rregullave.

*XIX.3.1* OST-ja do të përgatisë një draft amendimi ose modifikimi.

*XIX.3.2* OST-ja do të konsultohet me palët mbi amendimin ose modifikimin.

*XIX.3.3* ERE do të vendosë nëse duhet miratuar amendimi ose modifikimi dhe datën e zbatimit.

*XIX.3.4* Amendimi ose modifikimi i Rregullave të Tregut do të publikohet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen e internetit të ERE-s dhe/ose OST-së.

XIX.3.5 OST dotë përshtatëkëto rregullave meparashikimet VKM-së nr. 519, datë 13.7.2016, "Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike", dhe do t'i paraqesë për miratim në ERE brenda afatit tëpërcaktuar për zbatueshmërinë e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike.

*XIX.3.6 ERE mund të vendosëpërjashtimin nga këto Rregullanëpërputhje me legjislacionin në fuqi.*

SHTOJCA A

Marrëveshjapër pjesëmarrjen në treg nr.datë

Marrëveshja për pjesëmarrje nëtregun e energjisë elektrike nënshkruhet sot në datën ______, midis Palëve:

- Operatorit të Sistemit të Transmetimit-Operatori i Tregut (OST-OT), i regjistruar nëregjistrintregtar(QendrënKombëtaretëRegjistrimit)mevendiminnr.31935dt.14.7.2004dhe selinë në _____,i përfaqësuarnga_______, këtu e më poshtë i quajtur OST-OT

- pjesëmarrësi nëtregun e energjisë elektrike, i regjistruar në______

menr._____

dheselinë _______,ipërfaqësuar

nga _______,këtuemëposhtëiquajtur

KAPITULLI I

DISPOZITATEPËRGJITHSHME

Neni 1

1OST sh.a., në përputhje me ligjin nr.43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", neni 53, pika 1, është personi juridik i licencuar për kryerjen e transmetimin e energjisë elektrike.

Në bazë të Rregullave të Tregut Shqiptar tëEnergjisë Elektrike, kapitulli II, pika 2.4,të miratuara me vendimin nr. -------- të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, një

ndër funksionet e OST sh.a., është ai i Operatorit të Tregut.

2(Pjesëmarrësiitregut,palëekësajkontrate)në përputhje me nenin 37, tëligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", është mbajtës i licencës për _______, të dhënë nga ERE me vendimin nr._____, datë _______.

NëbazëtëkapitullitII tëRregullave tëTregutShqiptartëEnergjisë Elektrike,të miratuara me vendimin nr.68,______, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s (pjesëmarrësi i tregut, palë ekësajkontrate)_____,ka

funksionine_____(sipasaktivitetittëlicencuar)në

tregun shqiptar tëenergjisëelektrike.

## KAPITULLI II
## QËLLIMI I MARRËVESHJES

### Neni 2

Kjo marrëveshje rregullon marrëdhënietndërmjetpalëve që e nënshkruajnë atë, OST-OTdhe pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e detyrimeve dhe të drejtave që rrjedhin nga veprimtaria e tyre në tregun e energjisë.

## KAPITULLI III
## TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

### Neni 3

1Palët, bien dakord të pranojnë rolin dhe funksionin përkatës të tyre në tregun e energjisë elektrike, dhe angazhohen të zbatojnë me kujdesin e duhur ligjet, kodet, rregullat dhe praktikat tregtare që rregullojnë ose kanë të bëjnë me sektorin e energjisë elektrike dhe tregun e energjisë elektrike.

2Palët, bien dakord të ndërtojnë dhe zbatojnëmarrëveshje dhe kontrata me pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike nëpërputhje me Rregullat e Tregut.

3.Palët, bien dakord të shkëmbejnë informacione dhe tëdhëna në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse për informim nëpërputhje me Rregullat e Tregut.

4.Palëtmarrinpërsipërtëpërmbushindetyrimetfinanciarepërkatësenëpërputhjeme Rregullat e Tregut dhe marrëveshjet dypalëshe të lidhura nëpërputhje me to.Nëçdo rast Palët nuk do të ndërmarrin kompensimin e ndërsjellë të detyrimeve pa rakordimin dhe miratimin e palëstjetër.

## KAPITULLI IV
## PJESËMARRËSI NË TREG

### Neni 4

1. Pjesëmarrësi në treg bie dakord që t'u përmbahet në çdo kohë Rregullave të Tregut, gjithë kodeve teknike shoqëruese, dhe procedurave të brendshme tëOST-OT që nevojiten për funksionimin e tregut të energjisë elektrike.

2.Të gjitha aktet e brendshme tëOST-OT sipas pikës 4.1, të cilat pjesëmarrësi do të duhet t'i zbatojë do të vendosin detyrime, të cilat nuk i tejkalojnë detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore nëfushën e energjisë elektrike dhe në aktet e nxjerra nga ERE.

Neni 5

1.Pjesëmarrësi në treg është i detyruar të informojëOST-OT në lidhje me çdokontratë të lidhur. Ai duhet tëdorëzojë nëOST-OT informacion përçdo kontratë, duke identifikuar si më poshtë:

i) identifikimin e palëve të kontraktuara;

ii)pikat e livrimit/tërheqjes;

iii)kohëzgjatjen e kontratës;

iv)sasitë e kontraktuara dheprogramet orare të zbatueshme.

Këtokërkesadotëzbatohenpërgjithëkontratatdypalëshe,përshirëkontratatpër eksport/import.

2.Kontrata e lidhur ndërmjet dy pjesëmarrësve në treg, bëhet efektive pasi OST-OT të ketë konfirmuar marrjen e saj. OST-OT duhet të konfirmojë marrjen e një kontrate të tillë brenda jo më vonë se 10 ditë pune. Mungesa e konfirmimitbrenda këtij afati e bën efektive kontratën.

Neni 6

Pjesëmarrësi në treg duhet tëdorëzojë tek OST-OT njoftimet lidhur me gjithë shkëmbimet fizike neto mes palëve individuale (njoftime kontraktuale) ose ndërmjet palëve përgjegjëse për balancimin, me qëllim realizimin fizik të detyrimeve kontraktuale.

Neni 7

1.Pjesëmarrësi në treg do t'i paraqesinOST-OT një program ditor në përputhje me procesin e programimit të ditës në avancë, siç specifikohet në Kodin e Rrjetit, me qëllim qëOST-OT të përcaktojë formatin e programit ditor.

2.Forma dhe mënyra e paraqitjes së programit ditor dhe procedurat e tjera ndihmëse janë objekt i përcaktimit të OST sh.a., nëpërputhje me kodet e rrjetit dhe Rregullat e Tregut.

Neni 8

1.Pjesëmarrësi në treg do të marrëpërgjegjësipër balancimin përkundrejt OST-sëpërgjithë

prodhimin, blerjen, importin, eksportin, shitjen ose konsumin e tij.

2.OST-OT do të marrëpërgjegjësipër balancimin e energjisë sëkërkuar nga pjesëmarrësi (kur është rasti). Në rast se kjo balancë nuk i ofrohet, pjesëmarrësi mund tëkërkojëshpërblimin. OST-OT do të jetëpërgjegjëse ndaj pjesëmarrësit dhe përçdo mosrealizim në kohë, substancë dhe formë të detyrimeve të saj që rrjedhin nga Rregullat e Tregut dhe kjo marrëveshje. Atje ku Rregullat e Tregut nuk e përcaktojnëpërgjegjësia do të nxirret në bazë të Kodit Civil.

3.Përcaktimi i çmimeve tëdisbalancave janë objekt i miratimit nga ERE.

## KAPITULLI V
## OST – OT

### Neni 9

OST-OT, ka të drejtë tëkërkojë nga pjesëmarrësi i tregut të gjithë informacionin e nevojshëm, nëpërputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, Kodin e Rrjetit dhe kodet teknikeshoqëruese, procedurat dhe protokollet e brendshme të OST-OT që nevojiten për funksionimin e tregut të energjisë elektrike.

### Neni 10

OST-OT është e detyruar të përdorë informacionin e siguruar nga pjesëmarrësi i tregut, nëpërputhje me Rregullat e Tregut tëEnergjisë Elektrike, Kodin e Rrjetit dhe kodet teknike shoqëruese, procedurat dhe protokollet e brendshme të OST-OT që nevojiten për funksionimin e tregut të energjisë elektrike.

### Neni 11

OST-OT do t'i bëjë të disponueshme çdo pjesëmarrësi në treg çdo informacion lidhur me operimin e tregut të energjisë elektrike të papërcaktuar si konfidencial ose komercialisht të ndjeshëm.

## KAPITULLI VI
## HYRJA NË FUQI DHE ZGJIDHJA/PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES

### Neni 12

1.Nënshkrimi i kësajmarrëveshjeështë kusht përpjesëmarrje nëtregun e energjisë elektrike. Nënshkrimi do të bëhet vetëm nga persona tëcilëtjanë të autorizuar drejtpërdrejtë në bazë të legjislacionit shqiptar apo me prokurëpër tëpërfaqësuarsecilën palë.

2.Kjo marrëveshje bëhet efektive dhe e detyrueshme përPalët nëdatënnënshkrimit të saj.

3.Kjo marrëveshjeështë pa afat dhe pjesëmarrësi mund ta zgjidhë duke i dhënë njoftim paraprak OST-OT. OST-OT nga ana e saj mund ta zgjidhëmarrëveshjenvetëmpër arsye tëmbështetura dhe vetëm pas miratimit të ERE-s.

Neni 13

Një pjesëmarrës tregu mund të tërhiqet nga tregu i energjisë elektrike me iniciativën e tij, bazuar në një njoftim me shkrim të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i këtij pjesëmarrësi. Njoftimi duhet paraqitur të paktën **3** muaj para datës kur duhet anuluar regjistrimi i pjesëmarrësit të tregut dhe duhet përfunduarmarrëveshja. Pas marrjes së këtij njoftimi, OST-ja do të informojë menjëherë të gjithë pjesëmarrësit e tjerë të tregut.

Neni 14

Nëse pjesëmarrësi nuk mund t'i plotësojë të gjitha kushtet e Rregullave të Tregut atëherë pjesëmarrësi ose OST-OT duhet të informojnëERE-n brenda 10 ditë pune nga konstatimi për kushtet.

Neni 15

OST-OT do të pezullojë veprimtaritë tregtare të pjesëmarrësve nëse plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

1.Pjesëmarrësi i tregut nuk përmbush më një ose më shumë kushte të nevojshme për regjistrimsipjesëmarrës tregu (siçpërcaktohetnëdispozitat për procedurat e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike).

2. Pjesëmarrësi i tregut nuk përmbush më kërkesat që lidhen me garancinë financiare ose nuk bën pagesat e tjera (të parashikuara nëdispozitat për procedurat e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike).

3.Pjesëmarrësi i tregut nuk respekton marrëveshjen për pjesëmarrjen në treg.

4.Pjesëmarrësi i tregut gjendet vazhdimisht fajtor për mosrespektimin e rregullave të tregut dhe gjithë kodeve të zbatueshme për tregun shqiptar të energjisë elektrike ose marrëveshjen financiare.

Neni 16

1. Nëse pjesëmarrësi i tregut nuk mund të provojë se e ka shmangur shkakun (shkaqet) që shkaktoi pezullimin e tij, gjatë periudhës së specifikuar në njoftimin për pezullim, atëherë OST-OT do të procedojë me përfundimin e marrëveshjes për pjesëmarrjen në treg.

2. Nëse ky vendim i OST-OT kundërshtohet nga pjesëmarrësiatëherë pas paraqitjes së ankesës,ERE-ja do të verifikojë nëse arsyet për pezullimin e veprimtarive tregtare janë të justifikuara dhe do ta japë vendimin brenda 15 ditëve punë nga marrja e ankesës.
3. Paraqitjanë ERE e ankesës nga pjesëmarrësi i tregut, pezullon zbatimin e vendimit të OST sh.a. deri në marrjen e vendimit nga ERE.

Neni 17

Nëse regjistrimi i pjesëmarrësit të tregut pezullohet atëherë të gjitha ofertat e mbetura pezull (tëreja) të pjesëmarrësit të tregutdo tëanulohenautomatikisht për gjithë periudhëne pezullimit.

Neni 18

1.OST-OT do ta përfundojë marrëveshjen për pjesëmarrje në treg të një pjesëmarrësi tregu në secilin nga këto raste:

i) nëse pjesëmarrësi në treg nuk përmbush më një ose disa nga kushtet e nevojshme për regjistrimin si pjesëmarrës tregu (siç përcaktohet në dispozitat për procedurat e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike);

ii)nësepjesëmarrësinëtregnukpërmbushmëkërkesatqëlidhenmegarancinë financiare, siç përcaktohet në dispozitat për procedurat e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike);

iii)nëse pjesëmarrësi i tregut nuk respekton marrëveshjen për pjesëmarrjen nëtreg;

iv)nëse pjesëmarrësi në treg gjendet vazhdimisht fajtor për mosrespektimin e rregullave të tregut dhe gjithë kodeve të zbatueshme për tregun shqiptar të energjisë elektrike.

2.Marrëveshja për pjesëmarrjen në treg do të revokohet automatikisht dhe menjëherë, kur pjesëmarrësit në treg i hiqet licenca nga ERE-ja.

Neni 19

Mosmarrëveshjet mes palëve që nuk janë arritur të zgjidhen në mënyrë miqësore do të lihen në kompetencën e ERE-s për t'u gjykuar. ERE do të japë vendimin e saj brenda 15 ditëve pune nga dita nga marrja e ankesës. Pavarësisht vendimit të ERE-s dhe pas arritjes sëkëtij vendimi, palët kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës për shqyrtimin gjyqësor të konflikteve. Gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo marrëveshjenënshkruhet në tri kopje, një për pjesëmarrësin në treg dhe dy për OST – OT.

Forma e kësajmarrëveshjeështë miratuar nga ERE si "Marrëveshjapërpjesëmarrjen në treg", me vendimin nr.

............., datë...............................................

# SHTOJCA B
# ORARI I NOMINIMIT FIZIK TË PROGRAMIT

Orari i operimit të tregut përfshirë nominimin fizik të programit dhe paraqitjen e ofertës dhe ofertës dhe më pas pranimin e kërkesës dhe pranimin e ofertës lidhur me çdo ditë është si më poshtë:

10:00Në ditën në avancë, OST-ja publikon parashikimin e kërkesës së ditës në avancë për çdo periudhë likuidimi. Kjo do të jetë në formën e nivelit të kërkesës së agreguar në MW, si dhe të kufirit të kërkuar të rezervës në MW.

11:00Furnizuesit e kualifikuar dhe tregtarët i dorëzojnë Operatorit të Tregut OST nominimin e tyre fillestar të fluksit të interkoneksionit.

11:30 Operatori i Tregut OST njofton furnizuesit e kualifikuar dhe tregtarët për statusin e nominimeve të fluksit të interkoneksionit të tyre lidhur me faktin nëse ka kapacitet të tepërt të interkoneksionit ose mungesëtë kapacitet të interkoneksionit.

12:00Afati kohor për pranimin e nominimeve të korrigjuara të fluksit të interkoneksionit.

12:30Konfirmimi i nominimeve tëinterkoneksionit nga Operatori i Tregut OST si nominime fizike të interkoneksionit dhe u njoftohen furnizuesve që nuk përfiton ngashërbimiuniversali furnizimit dhe tregtarëve të prekur.

13:00 Paraqitja e gjithë nominimeve të tjera fizike tek Operatori i Tregut OST.

13:00Paraqitja e kërkesave dhe ofertave tek Operatori i Tregut OST.

14:00 Në ditën në avancë deri në [24:00] në ditën kur Operatori i Tregut OST pranon kërkesat dhe ofertat për të balancuar sistemin në varësi të disbalancimeve të njoftuara që rezultojnë nga të dhënat e nominimit fizik dhe nga ndryshimet e njoftuara në parametrat e të dhënave dinamike.